



ANALIZË E MODELEVE ARSIMORE TË KONTABILITETIT NË SEKTORIN PUBLIK NË GJASHTË VENDE

Korrik 2024

© 2024 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore
1818 H Street NW,
Uashington, D.K. 20433
Telefon: 202-473-1000
Internet: www.worldbank.org

Ky dokument është produkt i stafit të Bankës Botërore, me kontribute të jashtme. Konstatimet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo të qeverive që përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton saktësinë, plotësinë apo aktualitetin e të dhënave të përfshira në këtë punim dhe nuk merr përgjegjësi për gabime, mosparaqitje apo mospërputhje të informacioneve apo në lidhje me përdorimin apo mospërdorimin e informacioneve, metodave, proceseve apo përfundimeve të paraqitura në të. Kufijtë, ngjyrat, emërtimet dhe çdo informacion tjetër që paraqitet në hartat e këtij dokumenti nuk nënkuptojnë nga ana e Bankës Botërore asnjë gjykim për statusin juridik të asnjë territori dhe nuk përbëjnë ndonjë mbështetje apo pranim të kufijve të paraqitur.

Asgjë në këtë punim nuk mund të përbëjë apo të interpretohet apo të konsiderohet si kufizim apo heqje dorë nga privilegjet dhe imunitetet e Bankës Botërore, të cilat mbeten veçanërisht të rezervuara.

Të drejtat dhe lejimet

Materialet e këtij dokumenti janë objekt i të drejtës së autorit. Duke qenë se Banka Botërore nxit shpërndarjen e njohurive të saj, ky dokument mund të riprodhohet, tërësisht ose pjesërisht, për qëllime jo komerciale, për sa kohë që është përmendur plotësisht titulli i këtij dokumenti.

Çdo kërkesë për të drejta dhe leje, përfshirë të drejtat dytësore, duhet t'i drejtohet Zyrës së Botimeve të Bankës Botërore, Banka Botërore, 1818 H Street NW, Uashington, D.K. 20433, SHBA; faks: 202-522-2625; postë elektronike: pubrights@worldbank.org.

Grafika e kopertinës: Kora Reichardt



PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Falënderime	3
Parathënie	4
Përmbledhje e studimit	5
1. HYRJE DHE KONTEKST	7
Arsimi kontabël për sektorin publik	7
2. ARSIMI PËR KONTABILITETIN NË SEKTORIN PUBLIK NË GJASHTË VENDE TË PËRZGJEDHURA	9
Panoramë e përgjithshme e arsimit për KSP-në	9
Rregullimi i arsimit për KSP-në	16
Arsimi për KSP-në në universitete	19
OPK-të dhe zhvillimi profesional në KSP	22
3. GJETJET DHE PËRFUNDIMET KRYESORE	26
Gjetjet kryesore	26
Përfundime	27
Shtojca 1. Shqipëria: Sistemi i integruar i planifikuar për formimin për kontabilitetin e sektorit publik	28
Shtojca 2. Modulet CIPFA për certifikimin për kontabilitetin në sektorin publik	30
Shtojca 3. Instituti i Kontabilistëve të Miratuar i Shqipërisë – projekt-kurs për certifikimin për SNKSP-të	31
Shtojca 4. Kualifikimet për kontabilitetin e sektorit publik në Afrikën e Jugut	33
Shtojca 5. Programi i doktoratës për kontabilitetin e sektorit publik në Afrikën e Jugut	34



SHKURTIME

ACCA	Shoqata e Kontabilistëve të Miratuar të Autorizuar
CIPFA	Instituti i Autorizuar i Financave dhe Kontabilitetit Publik
ZHVP	Zhvillimi i vazhduar profesional
KP-E	Komuniteti i Praktikës për Edukimin, PULSAR
SNE	Standardet Ndërkombëtare të Edukimit
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
ZHPF	Zhvillimi profesional fillestar
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
KKK	Kuadri kombëtar i kualifikimeve
OPK	Organizatë e profesionit kontabël
MFP	Menaxhimi i financave kublike
KSP	Kontabiliteti në sektorin publik
PULSAR	Programi i Kontabilitetit dhe Raportimit në Sektorin Publik
SAQA	Autoriteti Afrikanjugor i Kualifikimeve
SVKSP	Standardet Vietnameze të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ZICA	Instituti i Kontabilistëve të Miratuar i Zambias
KKZ	Kuadri i Kualifikimeve i Zambias



FALËNDERIME

Ky material informativ është produkt i shkëmbimit të njohurive dhe bashkëpunimit mes anëtarëve të Komunitetit të Praktikës për Edukimin (KP-E) të Programit për Kontabilitetin dhe Raportimin në Sektorin Publik (PULSAR). Ky raport u përgatit nga José Simón Rezk, specialist i lartë për menaxhimin financiar dhe DEP për KP-E, Natalia Konovalenko dhe Natalia Ostapiuk, konsulentë për menaxhimin financiar, me udhëheqjen teknike të Arman Vatyán, kryespecialist për menaxhimin financiar. Faqosja e këtij produkti u bë nga Kora Reichardt. Ky material ka marrë kontribute edhe nga recensuesit e mëposhtëm: Alfred Borgonovo, nëpunës i lartë financiar (Banka Botërore); dhe Patrick Piker Umah Tete, specialist i lartë për

menaxhimin financiar (Banka Botërore). Dëshirojmë të falënderojmë edhe ekspertët e mëposhtëm, për informacionet e vjera që na kanë dhënë mbi përvojën e vendeve të tyre: Davit Gamkrelidze (Thesari i Shtetit, Ministria e Financave, Gjeorgji), Erisa Rodhani (Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri), Noe Quiñanola (Këshilli Rregullator i Kontabilistëve Profesionistë i Filipineve), Patricia Mukangandu Hantumba (Instituti i Kontabilistëve të Miratuar i Zambias (ZICA), Pham Quang Huy (Universiteti i Shkencave Ekonomike, Vietnam) dhe Trudy Paul (Instituti i Kontabilistëve të Miratuar i Afrikës së Jugut (SAICA).



PARATHËNIE

Programi i Kontabilitetit dhe Raportimit në Sektorin Publik (PULSAR) ofron një mbështetje në nivel rajoni dhe vendi në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet e Partneritetit Lindor të Bashkimit Evropian, për zhvillimin e kuadrit të kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë.

Komuniteti i Praktikës për Edukimin i PULSAR-it (KP-E) përbëhet nga përfaqësues të ministrive të financave, universiteteve dhe organizatave të profesionit kontabël dhe punon në drejtim të përmirësimit të formimit, arsimit dhe zhvillimit të vazhduar profesional në sektorin publik, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë. Qëllimi i këtij komuniteti është nxitja e dialogut dhe bashkëpunimit

mes palëve të interesuara në nivel vendi dhe rajoni; mundësimi i shkëmbimit të përvojave dhe shembujve të praktikës së mirë; dhe nxitja e zhvillimit të kolektiv të zgjidhjeve për problemet e përbashkëta.

Ky studim jep një analizë të modeleve arsimore të KSP-së në gjashtë vende nga anë të ndryshme të botës. Studimi shqyrton ngjashmëritë dhe dallimet, si edhe sukseset dhe vështirësitë për arsimin në KSP. Studimi do të përdoret nga KP-E si bazë për diskutimet mbi rolin që luan arsim-formimi për të siguruar që të ketë kontabilistë shumë të kualifikuar të sektorit publik, të pajisur me shprehi dhe aftësi të përditësuara, si edhe diskutimet mbi zbatimin e standardeve të reja të kontabilitetit dhe kontributin e tyre në reformën e menaxhimit të financave publike.



PËRMBLEDHJE E STUDIMIT

Formimi i efektshëm i kontabilistëve të sektorit publik ka rëndësi për të siguruar që ata të jenë të aftë, të respektojnë standardet, të sillen me etikë dhe të kontribuojnë në besueshmërinë dhe saktësinë e raportimit financiar në sektorin publik. Kjo luan një rol të rëndësishëm për të mbështetur besimin e publikut, stabilitetin ekonomik dhe menaxhimin e efektshëm financiar.

Edhe pse kriteret arsimore për kontabilistët e sektorit publik kanë shumë të përbashkëta me sektorin privat, ka edhe disa dallime të rëndësishme. Për të kuptuar kornizat e ndryshme arsimore të KSP-së, KP-E i PULSAR-it kreu një shqyrtim të hollësishëm të arsimit kontabël në gjashtë vende: Afrikë e Jugut, Filipine, Gjeorgji, Shqipëri, Vietnam dhe Zambia. Janë përzgjedhur këto vende për të ilustruar nivelet e ndryshme të zhvillimit të elementeve të ndryshme të arsimit të KSP-së në mbarë rajonet.

Studimi mbulon këto elemente kryesore të arsimit të KSP-së:

1. Kuadri arsimor kontabël.
2. Bashkërendimi i procesit arsimor.
3. Arsimi i lartë dhe zhvillimi profesional fillestar (ZHPF).
4. Formimi në nivel të organizatave të profesionit kontabël (OPK) dhe të zhvillimit të vazhduar profesional (ZHVP).

Studimi mbështetet në diskutimet e modeleve arsimore të KSP-së, siç janë paraqitur nga gjashtë vendet në kuadër të dy aktiviteteve inteligjente ndëraktive,¹ të organizuara në kuadër të KP-E të programit PULSAR. Palë kyçe interesi nga këto vende, nga entet rregullatore, OPK-të apo universitete

kryesore, kanë përshkruar modelin e arsim-formimit të kontabilitetit në sektorin publik, siç është vënë në zbatim në vendet e tyre. Diskutimet e aktiviteteve inteligjente ndëraktive janë plotësuar me anketën e plotësuar nga prezantuesit dhe me intervista të kryera nga ekipi i KP-E-së me palë kryesore, për të siguruar njëtrajtshmërinë në mbulim.

Gjetjet kryesore janë këto:

- Kalimi drejt Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) ka nxjerrë në pah nevojën për të përmirësuar aftësitë e kontabilistëve të sektorit publik.
- Asnjëri prej vendeve të shqyrtuara nuk ka kualifikime enkas për KSP-në apo kriteret e njëtrajtshme certifikimi për kontabilistët e sektorit publik. Kjo mund të sjellë boshllëqe në shprehje dhe njohuri bazë për KSP-në.
- Vendet po e rritin vëmendjen ndaj formimit të posaçëm për KSP-në, por gjithsesi ky formim mbetet i paplotë.
- Si ZHPF-ja, ashtu edhe ZHVP-ja, përqendrohen më së shumti në njohuritë e përgjithshme kontabël dhe në nevojat e sektorit privat.
- Rregullimi i arsimit për KSP-në shpesh bëhet nga ministritë përkatëse me bashkëpunimin aktiv të OPK-ve.
- Shumë pak tema të KSP-së përfshihen në pjesën më të madhe të arsimit në nivel të ZHPF-së, por ka përmirësim.
- Shumë pak vende kanë kriteret e veçanta kualifikimi/certifikimi për kontabilistët që të punojnë në sektorin publik dhe, kur ka të tilla, këto kriteret nuk janë posaçërisht për KSP-në.

¹ <https://cfr.worldbank.org/news/pulsar-smart-interactive-talk-accounting-education-public-sector-international-experiences-0>

- Disa vende po mendojnë një kërkesë ligjore më zyrtare enkas për certifikimin e kontabilistëve të sektorit publik.
- Disa vende po kërkojnë të zbatojnë kualifikime dhe programe arsimore me emërtimin "KSP".
- OPK-të luajnë një rol jetik në dhënien trajtë të arsimit, formimit dhe zhvillimit profesional të kontabilistëve, por në përgjithësi e kanë përqendruar vëmendjen te sektori privat, kështu që kontabilistëve të sektorit publik u mungon kontrolli mbikëqyrës i OPK-ve, një certifikim i veçantë profesional apo një ZHVP i synuar.
- Kontabilistët e sektorit publik të cilët janë anëtarë të OPK-ve janë të detyruar të ndjekin ZHVP, por kjo mund të mos vlejë për të gjithë kontabilistët e sektorit publik.
- ZHVP ofrohet më së shumti nga OPK-të. Disa vende kanë institucione shtetërore të formimit dhe disa përfshijnë universitete dhe ofruar të tjerë të formimit profesional.

Gjetjet mbështetin këto përfundime:

- Pengesat kryesore ndaj sistemeve efikase të arsimit për KSP-në kanë të bëjnë me mënyrën e copëzuar të zbatimit të tij dhe mbulimin e pamjaftueshëm të temave të sektorit publik në ZHPF-në e ofruar nga universitetet dhe OPK-të.
- Nën shtytjen e programeve për vënien në zbatim të SNKSP-ve, të gjitha vendet e vrojtura po bëjnë punë të konsiderueshme për t'u dhënë zgjidhje pengesave dhe për të vënë në jetë ose për të përmirësuar një sistem koherent dhe të gjithanshëm arsimi, formimi dhe certifikimi të kontabilistëve të sektorit publik, përgjithësisht në bashkërendim me një kriter për ZHVP.
- Puna për reformat shpesh mbështetet nga organizata të huaja donatore dhe mund të shërbejë si një model për vendet e tjera që i kanë hyrë të njëjtit rrugëtim. Programi PULSAR mbështet aktivisht përmirësimet e kapacitetit dhe aftësive të kontabilistëve të sektorit publik.

1



HYRJE DHE KONTEKST

ARSIMI KONTABËL PËR SEKTORIN PUBLIK

1. Arsimi kontabël për sektorin publik luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies së informacioneve financiare të hartuara nga njësitë ekonomike publike. Kjo kontribuon në një administrim efikas dhe efektiv të financave publike.

2. Një arsim i mirë për KSP-në kontribuon në:

- **Sigurimin e llogaridhënies:** Sektori publik është përgjegjës për administrimin e fondeve dhe burimeve publike dhe arsimi kontabël ndihmon për të siguruar që kontabilistët e sektorit publik të kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për mbajtjen e të dhënave të sakta dhe transparente financiare. Kjo ndihmon për të nxitur llogaridhënien dhe për të parandaluar krimin ekonomik dhe korrupsionin.
- **Përputhshmërinë me standardet:** Sektori publik është objekt i standardeve të ndryshme të raportimit financiar, si SNKSP-të dhe parimet përgjithësisht të pranuar kontabël dhe arsimi kontabël ndihmon për të siguruar që kontabilistët e sektorit publik të njihen me këto standarde dhe të mund t'i respektojnë ato.
- **Menaxhimin financiar efektiv:** Arsimi kontabël u jep kontabilistëve të sektorit publik njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të administruar në

mënyrë të efektshme fondet dhe burimet publike, përfshirë përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, analizën financiare dhe matjen e rezultateve.

- **Profesionalizmin dhe etikën:** Arsimi kontabël e vë theksin te rëndësia e profesionalizmit dhe etikës në profesionin kontabël, që është sidomos e rëndësishme në sektorin publik ku besimi i publikut është thelbësor.
- **Ecjen në karrierë:** Arsimi kontabël u jep studentëve njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ecur në karrierë në sektorin publik, përfshirë dikastere, organizata jofitimprurëse dhe njësi të tjera të sektorit publik. ZHVP-ja ka rëndësi për karrierën në kontabilitet.

3. Qëllimi kryesor i procesit arsimor është të sigurojë prurje të profesionistëve kontabël, me formim, kualifikime dhe përvojën e duhur, të pajisur për të mbështetur administrimin e burimeve publike dhe për të ndihmuar llogaridhënien, që, nga ana e saj, do të mbështetë formimin e brezit të ardhshëm të specialistëve.

4. Ka shumë rëndësi një kuadër arsimor kontabël i cili përqendrohet konkretisht në nevojat e sektorit publik, sepse ndihmon për të siguruar që kontabilistët e sektorit publik të kenë njohuritë dhe shprehitë e nevojshme për të administruar në mënyrë të efektshme fonde dhe burimet publike, për të respektuar standardet e raportimit financiar dhe për të ruajtur besimin e publikut dhe llogaridhënien, si edhe për të mbajtur të përditësuar aftësitë

dhe njohuritë e tyre profesionale. Mungesa e kritereve të dallueshme për arsimin ose certifikimin e kontabilistëve që punojnë në sektorin publik mund të bëjë që personelit t'i mungojnë njohuritë e mjaftueshme dhe formimi për politikën, detyrat dhe terminologjinë e posaçme kontabël të sektorit publik. Kjo mund të bëjë që një kohë e konsiderueshme të shpenzohet për formimin në punë të specialistëve kontabël, të ketë shkallë të lartë qarkullimi të personelit dhe, për pasojë, mund të ndikojë në besueshmërinë dhe aktualitetin kohor të informacioneve kontabël.

5. Arsimi kontabël zakonisht ka një sërë etapash, ku përfshihen:

- **ZHPF** në universitet ose në nivel të OPK-së. Ky përfshin:
 - Aftësi teknike
 - Shprehi profesionale
 - vlerat, etikën dhe qëndrimet profesionale
 - Përvojë praktike
 - Vlerësim të kompetencës profesionale
- **ZHVP** nëpërmjet OPK-ve, ofruesve të tjerë dhe studimit autodidakt. Ky ka për qëllim:
 - Të sigurojë që kontabilistët të mbajnë të njëjtin nivel përmbushjeje të standardeve profesionale
 - T'i ndihmojë ata të përditësohen me zhvillimet më të fundit, normat dhe praktikën më të mira në fushën kontabël.

6. **Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (SNE)** i publikon Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK). Këto standarde vendosin parimet për të ngritur një profesion kombëtar kontabël i cili të jetë plotësisht i aftë të përmbushë kërkesa komplekse. SNE-të japin

parimet, konceptet dhe përkufizimet bazë të cilat e çojnë përpara arsimin kontabël. Megjithatë jo të gjitha SNE-të janë bërë enkas për KSP-në, ato kanë për qëllim të sigurojnë kompetencat bazë të cilat mund të përshtaten për çdo sektor apo rol.

7. Gjatë përgatitjes së kontabilistëve të sektorit publik, institucionet arsimore mund të përfshijnë fusha të tjera shtesë të kompetencës; të rrisin nivelin e zotësisë të fushave të kompetencës; ose të zhvillojnë rezultate mësimore shtesë në përshtatje të nevojave të veçanta, siç janë ato të identifikuar në **Kuadrin e elementeve të aftësisë për sektorin publik** të përgatitur në KP-E PULSAR.² Formimi i kontabilistëve të sektorit publik do të duhej të mbulonte veçantitë e procesit të zbatimit të buxhetit, si edhe lidhjet midis reformës së menaxhimit të financave publike dhe kontabilitetit. Rrjedhimisht, ngritja e një kuadri të qartë zhvillimi profesional të kontabilistëve në sektorin publik me një paketë të përcaktuar aftësish dhe kualifikimesh luan rol të rëndësishëm në ofrimin e një shërbimi cilësor nga këta profesionistë dhe arritjen e qëllimit të përgjithshëm të menaxhimit efikas dhe efektiv të menaxhimit të financave publike.

8. Në rubrikën e mëposhtme shihen elementet arsimore për KSP-në në nivel ZHPF-je dhe ZHVP-je në vendet e vrojtuar: kuadri arsimor për KSP-në; bashkërendimi i procesit arsimor; ofrimi i arsimit enkas për KSP-në në nivel të universiteteve dhe ZHPF-së dhe në nivel të OPK-ve dhe ZHVP-së. Ajo përqendrohet te procesi i bashkërendimit të arsimit dhe përfshirja e palëve të interesit në përpjekje për të kuptuar më mirë qasjen dhe kërkesat e vendeve të ndryshme për arsimin për KSP-në, për të identifikuar shembuj të reformave dhe të praktikës së mirë që mund të jenë të dobishme për vendet e programit PULSAR në përpjekjet e tyre për të formuar specialistë të aftë dhe me etikë të KSP-së.

² <https://cfr.worldbank.org/publications/toolkit-public-sector-accounting-education-plan>

2



ARSIMI PËR KONTABILITETIN NË SEKTORIN PUBLIK NË GJASHTË VENDE TË PËRZGJEDHURA

9. Për këtë studim, KP-E identifikoi gjashtë vende për vërtetim, në pjesë të ndryshme të botës: Afrika e Jugut, Filipinet, Gjeorgjia, Shqipëria, Vietnamit dhe Zambia. Të gjitha këto vende kishin filluar reformën e sistemit kontabël në bazë të zbatimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të SNKSP-ve dhe qeveria e secilit vend ka dëshmuar angazhim të fortë për t'i dhënë zgjidhje ofrimit të arsimit cilësor për KSP-në brenda një kuadri konceptual bashkëkohor. Përzgjedhja e vendeve kishte për synim të sigurote larmi në mbulim gjeografik dhe në nivelin të zhvillimit të elementeve të ndryshme të arsimit të KSP-së.

10. Secili prej vendeve iu përgjigj anketës, çka u pasua me intervista me palë kryesore interesi. Gjetjet u shqyrtuan për të bërë krahasime dhe për të dalë me përfundime.

PANORAMË E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PËR KSP-NË

11. Gatishmëria e një numri të mjaftueshëm profesionistësh tejet të kualifikuar për KSP-në ka

rëndësi të madhe për të siguruar informacione financiare transparente dhe cilësore për një administrim të efektshëm të fondeve dhe burimeve publike dhe për të ruajtur besimin që ka publiku dhe nivelin e llogaridhënies. Formimi i një numri të qëndrueshëm profesionistësh të KSP-së të cilët përmbushin dhe ruajnë standarde të larta të aftësive profesionale kërkon përpjekje të konsiderueshme nga ana e rregullatorëve, OPK-ve, institucioneve arsimore dhe palëve të tjera të interesit. Arsimi për KSP-në duhet të synojë si më poshtë:

- formimi i një numri të mjaftueshëm kontabilistësh profesionistë për plotësuar nevojat e sektorit publik të vendit;
- mbështetja e ruajtjes së njohurive dhe aftësive të përditësuara profesionale të kontabilistëve të sektorit publik gjatë gjithë karrierës.

12. Në funksion të këtij raporti, është parë i gjithë kuadri arsimor për kontabilistët, përfshirë ZHPF-në, ZHVP-në dhe programet e certifikimit, kur ka. Në tabelën e mëposhtme jepet një panoramë e shkurtër e kuadrit arsimor për kontabilistët e sektorit publik në vendet e shqyrtuara.

SHQIPËRIA



Statusi lidhur me SNKSP-të

Ka filluar në vitin 2018 një projekt me disa faza për përdorimin e SNKSP-ve në sektorin publik të Shqipërisë, që planifikohet të përfundojë në vitin 2027.

Kërkesat lidhur me kontabilistët e sektorit publik

Nuk ka një OPK për kontabilistët e sektorit publik. Nuk ofrohet arsim apo kualifikim profesional për KSP-në.

ZHPF

Universitetet shqiptare ofrojnë programe të ndryshme kontabiliteti në nivele të ndryshme arsimore, por pak mbulohet me program mësues raportimi financiar në sektorin publik, sidomos SNKSP-të. Shqipëria po zhvillon aktivisht kuadrin arsimor për KSP-në dhe ka ecur ndjeshëm përpara sa i takon zhvillimit të një sistemi unik arsimor për KSP-në. Në bashkëpunim me Institutin e Autorizuar të Financave dhe Kontabilitetit Publik (CIPFA), Shqipëria është në proces të ndryshimit të programeve të lëndëve të kualifikimeve kontabël në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve të arsimit të lartë, për të përfshirë përmbajtjen e duhur për menaxhimin e financave publike dhe KSP-në dhe, mundësisht, për të shtuar një modul më vete për KSP-në në vitet e ardhshme akademike mbështetur në SNKSP-të. Ky do të jetë një hap i rëndësishëm.³

ZHVP

Nuk ka një lidhje të fortë mes sistemit universitar dhe ZHVP-së. Nuk ka kërkesa ligjore në lidhje me ZHVP-në për kontabilistët e sektorit publik.

Burimet e formimit në KSP

Në kuadër të zbatimit të reformës së menaxhimit të financave publike, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, organizon sipas kërkesës formim për kontabilistët e sektorit publik. Është zbatuar në vitin 2022 një program i formimit të instruktorëve të formimit,⁴ me synim formimin e kontabilistëve të sektorit publik në fushën e SNKSP-ve.⁵ Po diskutohet për vënien në zbatim të një kualifikimi profesional për SNKSP-të.

³ Një studim i CIPFA/Bankës Botërore në nëntor 2022 për KSP-në në universitete të ndryshme shqiptare konstatoi mbulim të kufizuar ose të munguar të kësaj teme në nivelin e parë ose të dytë të studimeve.

⁴ <https://documents1.worldbank.org/curated/en/220821534747695850/pdf/129511-WP-PUBLIC-benchmarking-study.pdf>

⁵ Programi përfshinte: program formimi për instruktorë mbi raportimin financiar dhe kontabilitetin në sektorin publik mbështetur në SNKSP (28 pjesëmarrës); pilotim i formimit për herë të parë të personelit të financës dhe kontabilitetit në institucionet e pushtetit qendror mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik mbështetur në SNKSP (100 kontabilistë nga rreth 20 institucione të ndryshme); formim për kontabilistë dhe nëpunës të financës lidhur me raportimin financiar dhe kontabilitetin në sektorin publik mbështetur në SNKSP (400 kontabilistë).

GJEORGJIA



Statusi lidhur me SNKSP-të

Në mandatin e Thesarit të Shtetit, prej vitit 2009 bën pjesë edhe funksioni i vendosjes së standardeve. Kjo strukturë ka nisur kalimin drejt kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik, në përputhje me SNKSP-të. Kjo ka filluar me buxhetin qendror, pastaj prej vitit 2017 janë përfshirë edhe njësitë e qeverisjes vendore, ndërsa prej vitit 2021 agjencitë e sektorit publik i paraqesin pasqyrat financiare në bazë të 24 SNKSP-ve.

Kërkesat lidhur me kontabilistët e sektorit publik

Nuk ka kërkesa ligjore apo rregullatore lidhur me aftësitë dhe njohuritë e veçanta të kontabilistëve të sektorit publik. Programet e certifikimit profesional, të propozuara nga Federata e Kontabilistëve dhe Audituesve Profesionistë të Gjeorgjisë (OKP-ja kryesore në vend) janë programe të përgjithshme për formimin e kontabilistëve, mbështetur në programin mësimor të Shoqatës së Kontabilistëve të Miratuar të Autorizuar (ACCA), ku nuk para mbulohet shumë KSP-ja. Nuk propozohet nga OPK-të apo nga Akademia e Ministrisë së Financave ndonjë certifikim më vete për kontabilistët e sektorit publik.

ZHPF

Arsimi i lartë rregullohet nga kuadri i dy ligjeve: ligji për arsimin e lartë dhe ligji për rritjen e cilësisë arsimore, si edhe nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Nuk ka ende kualifikime më vete për kontabilistët e sektorit publik në nivel të ciklit të parë apo të dytë të studimeve të larta, por lëndët e fushës së KSP-së pasqyrohen pjesërisht në programet e ciklit të parë të disa universiteteve. Nevoja për të fuqizuar arsimin e KSP-së në nivel të ZHPF-së dhe të ZHVP-së njihet gjerësisht nga entet rregullatore dhe nga bashkësia e profesionistëve.

ZHVP

Nuk ka kërkesa ligjore në lidhje me ZHVP-në për kontabilistët e sektorit publik.

Burimet e formimit në KSP

Mësimdhënia për KSP-në mbetet përgjithësisht përgjegjësi e Akademisë së Ministrisë së Financave. Kjo akademi zhvillon formim në lidhje me SNKSP-të apo formim të instruktorëve të formimit, në bazë të nevojave të sektorit.

FILIPINET



Statusi lidhur me SNKSP-të

Vendimi për të futur në zbatim SNKSP-të u mor nga qeveria e Filipineve në vitin 2014. Procesi i ndryshimi është udhëhequr nga Komisioni për Auditimin, përgjegjës për kontabilitetin dhe raportimin financiar.

Kërkesat lidhur me kontabilistët e sektorit publik

Ligji për kontabilitetin i vitit 2004 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij njohin zyrtarisht praktikën në sektorin publik si një prej katër sektorëve të profesionit kontabël. Certifikimi me dy nivele i kontabilistëve dhe audituesve mbulon edhe kontabilistët e sektorit publik. Nuk ka kualifikim më vete për kontabilistët e sektorit publik. Kërkesat ligjore për akreditimin e të gjithë kontabilistëve ushtrues të profesionit, përfshirë edhe në sektorin publik, janë: përvojë në sektorin publik prej të paktën 3 vjetësh; përfundimi i 120 krediteve ZHVP; dhe kalim i shqyrtimit të vlerësimit të cilësisë, ripërtërihet çdo 3 vjet.

ZHPP

Ka programe arsimore të zhvilluara mjaft mirë, si në nivel të ZHPP-së, ashtu edhe në nivel të ZHVP-së. Sistemi arsimor për SKP-në është përditësuar për të përfshirë SNKSP-të. Disa universitete kanë kualifikime dhe programe të veçanta për KSP-në në nivel të ciklit të parë dhe të dytë të arsimit të lartë (Universiteti i Filipineve, Universiteti Politeknik i Filipineve, Universiteti i Manilës, Universiteti i Shën Agustinit).

ZHVP

Ka një lidhje të fortë mes arsimit universitar (ZHPP) dhe nivelit të ZHVP-së që vjen më pas. Shoqata Qeveritare e Kontabilistëve Publikë të Miratuar, OPK-ja e kontabilistëve të sektorit publik, ofron në vazhdimësi formim ZHVP për anëtarët.

Burimet e formimit në KSP

Universitetet dhe OKP-të. Njihet gjerësisht nevoja për fuqizimin e kapaciteteve në të gjithë qeverinë, çka ka çuar në një program të gjerësishtëm formimi me përfshirjen e personelit financiar në të gjitha nivelet e qeverisjes. Mbi 21.000 punonjës shtetërorë kanë marrë pjesë në kurset e formimit të organizuara nga Komisioni për Auditimin.⁶

⁶ <https://www.coa.gov.ph/>

AFRIKA E JUGUT



Statusi lidhur me SNKSP-të

Afrika e Jugut ka vënë në zbatim "Praktikën përgjithësisht të njohur kontabël", përgatitur nga Bordi i Standardeve të Kontabilitetit të Afrikës së Jugut mbështetur në SNKSP.

Kërkesat lidhur me kontabilistët e sektorit publik

Fjalorët e kompetencave teknike, përgatitur nga Thesari i Shtetit, mbulojnë grupet kryesore profesionale në fushën e menaxhimit të financave publike. Në to përkrahën njohuritë, aftësitë dhe përvoja e punës, të cilat duhet t'i ketë një profesionist i aftë për të kryer një sërë detyrash standarde në nivele të ndryshme përgjegjësie brenda funksionit të përgjithshëm. Janë përgatitur gjithsej 10 fjalorë me qëllim për të ndihmuar në zhvillimin e burimeve njerëzore. Fjalori i Kompetencës për Menaxhimin e Financave Publike trajton çështje që kanë të bëjnë me ZHPF-në, përvojën praktike në punë dhe ZHVP-në, duke ndërthurur kështu të gjitha elementet e arsimit kontabël në një sistem të vetëm arsimor të ndërlidhur dhe të harmonizuar.

ZHPF

Afrika e Jugut ka një sistem të fortë dhe të strukturuar mirë të arsimit për KSP-në. ZHPF-ja ofrohet më së shumti nga universitetet dhe institucione të tjera arsimore, mbështetur në programe lënde të regjistruara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK). Disa universitete kanë kualifikime dhe programe të posaçme për KSP-në në nivel hyrës (pas shkollë) deri në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve të larta.

ZHVP

Kërkesat për ZHVP-në janë në Fjalorin e Aftësive të Menaxhimit të Financave Publike.

Burimet e formimit në KSP

Kualifikime në nivel teknik enkas për KSP-në, të ofruara nga OPK-ja "Teknikët kontabël të Afrikës së Jugut" (themeluar nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Afrikës së Jugut në vitin 2008), janë zhvilluar me mbi 5800 punonjës të sektorit publik në 59 zyra të ndryshme në nivel qendror, provinca dhe bashki në mbarë vendin.⁷

⁷ <https://saicawebprstorage.blob.core.windows.net/uploads/A-Professionalisation-of-the-Public-Service-26.02.pdf>

VIETNAMI



Statusi lidhur me SNKSP-të

Ministria e Financave ka publikuar një dokument udhërrëfyes për kalimin drejt standardeve të bazuara në SNKSP me të drejta dhe detyrime të konstatuara (Standardet Vietnameze të Kontabilitetit të Sektorit Publik, SVKSP) brenda vitit 2024. OPK-të vietnameze janë në proces të futjes në zbatim të SVKSP-ve. Deri në tetor 2023, ishin publikuar 11 SVKSP, ndërsa 5 SVKSP të tjera u publikuan deri në fund të vitit 2023.

Kërkesat lidhur me kontabilistët e sektorit publik

Certifikimi i kontabilistëve publikë të regjistruar përdoret për kontabilistët në sektorin privat dhe atë publik. Nuk ka certifikim më vete për KSP-në, por mund të ketë zhvillime në këtë fushë.

ZHPF

Arsimi kontabël në sektorin publik është i copëzuar, por po zhvillohet vullshëm. Aktualisht, ka dy programe të lidhura me KSP-në: 1) një program kualifikimi për kontabilistët e sektorit publik në ciklin e parë të studimeve ofrohet nga disa universitete kryesore; 2) një kurs i shkurtër për të fituar certifikatën e shefit të llogarisë në njësi administrative dhe jo ekonomike. Po mendohet edhe zhvillimi i një programi të specializuar në ciklin e dytë të studimeve në universitet.

ZHVP

Planifikohet të organizohet në ndërveprim të ngushtë të ZHPF-së dhe ZHVP-së.

Burimet e formimit në KSP

Universitetet dhe Shoqata Vietnameze e Kontabilistëve Publikë të Miratuar.

ZAMBIA



Statusi lidhur me SNKSP-të

Në proces të kalimit të SNKSP-ve të plota, që pritet të përfundojë në vitin 2024.

Kërkesat lidhur me kontabilistët e sektorit publik

Nuk ka një certifikim të posaçëm për kontabilistët e sektorit publik. Të gjithë kontabilistët duhet të kenë një kualifikim të njohur profesional në fushën e kontabilitetit, që ofrohet nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar i Zambias (ZICA) dhe OPK të tjera vendase dhe të huaja, si ACCA etj. Të gjithë kontabilistët ushtrues të profesionit (përfshirë në sektorin publik) duhet të jenë anëtarë të një OPK-je për të ushtruar profesionin e kontabilistit.

ZHPF

Arsimi për KSP-në është mjaft mirë i zhvilluar, paçka se i copëzuar. Do të vijojë të zhvillohet në përputhje me zbatimin aktual të reformës së menaxhimit të financave publike. Arsimi për KSP-në ofrohet në nivel të ZHPF-së por edhe të ZHVP-së, dhe ndjek udhëzimet e FNK-së për standardet arsimore. Niveli ZHPF ofrohet nga subjekte të miratuara nga ZICA, që janë institucione të arsimit të lartë me akreditim kombëtar. Programet e ZHPF-së janë në nivel diplome dhe në ciklin e dytë të studimeve: përkatësisht Diploma për Kontabilitet në Sektorin Publik me provim nga ZICA dhe programi i Kontabilistëve të Autorizuar të Zambias.

ZHVP

Kërkesat për ZHVP-në zbatohen për të gjithë kontabilistët, përfshirë edhe kontabilistët e sektorit publik. Formimi ZHVP ofrohet nga OPK-të.

Burimet e formimit në KSP

Institucionet e arsimit të lartë dhe OPK-të.

RREGULLIMI I ARSIMIT PËR KSP-NË

13. Ka disa qasje për rregullimin e arsimit të kontabilitetit të sektorit publik në vendet e studiuara:

- a. Ministria e financave luan rol kryesor në vendosjen e standardeve për kontabilistët, në nivel të ZHPF-së dhe të ZHVP-së, ndërsa ministria e arsimit vendos standardet për programet arsimore të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë;
- b. Rregullimi i arsimit profesional me anë të OPK-ve;
- c. Qasje hibride, ku entet rregullatore bashkërendojnë nga afër punën për të rregulluar arsimin profesional kontabël me OPK-të.

14. **Qasja e parë** përdoret nga Afrika e Jugut, Filipinet, Gjeorgjia, Shqipëria dhe Vietnami. Ministrinë e financave të këtyre vendeve përcaktojnë kriteret minimale për kontabilistët e sektorit publik (në disa raste ka kriteret minimale për kontabilistët e sektorit publik dhe atij privat) ose vendosin kushte që duhen përmbushur nga kontabilistët ushtrues të profesionit dhe ndjekin përmbushjen e këtyre kriterëve. Asnjëri prej vendeve të shqyrtuara nuk ka një kërkesë ligjore lidhur me certifikim më vete profesional për kontabilistët e sektorit publik, por disa vende (Shqipëria, Zambia) kanë menduar ose po mendojnë futjen në zbatim të një certifikimi të tillë në të ardhmen.

15. **Qasja e dytë** përdoret mjaft gjerësisht në vendet e zhvilluara me një profesion kontabël të pjekur. Nuk ka kriteret të veçanta të vendosura nga shteti, por i lejohet profesionit të rregullojë vetë arsimin kontabël për KSP-në me anë të OPK-ve. Nuk zbatohet në asnjërin prej vendeve të shqyrtuara.

16. **Qasja e tretë** përdoret në Zambia dhe pjesërisht në Filipine (ku OPK-ja kryesore propozon anëtarë të këshillit rregullator). Bashkërendimi i arsimit kontabël bëhet nga enti rregullator (ministria e financave, thesari i shtetit ose një organ tjetër shtetëror) në bashkëpunim të ngushtë me OPK-të, përfshirë hartimin e kornizave të kualifikimit minimal, model-programet mësimore, ZHVP-në dhe kërkesa të tjera, që monitorohen nga OPK-të në lidhje me anëtarët e tyre.

17. Në praktikë, nuk ka shumë dallim midis qasjes së parë dhe qasjes së tretë. Në të gjitha vendet e shqyrtuara, rregullimi i arsimit të KSP-së është, deri diku, përgjegjësi e përbashkët e ministrive të financave dhe OPK-ve, vetëm në kombinime të ndryshme.

18. Në vijim të kësaj pjese jepen përshkrime të shkurtra të rregullimit të arsimit për kontabilistët e sektorit publik në vendet e shqyrtuara.

SHQIPËRIA

19. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i është ngarkuar detyra e rregullimit të përgjithshëm dhe monitorimit të zbatimit të reformës së KSP-së, ku përfshihet objektivi i zhvillimit të kapaciteteve dhe aftësive profesionale në fushën e kontabilitetit. Për të përmbushur këtë, ministria është angazhuar për përgatitjen e një kuadri arsimor për zhvillimin e profesionistëve të KSP-së, një program të ZHVP-së dhe (në periudhën afatmesme) një program certifikimi për kontabilistët e sektorit publik, me qëllim vendosjen e një rruge tërësore arsimore për sektorin publik. Reformat po zbatohen në bashkëpunim me OPK-të, universitetet dhe institucionet e njohura ndërkombëtare.

20. Nuk ka arsim ose kualifikim profesional të ofruar në fushën e financave dhe kontabilitetit të sektorit publik, as një organ profesional në Shqipëri për personelin financiar të sektorit publik. Por është përgatitur bashkërisht me CIPFA-n një modul i ri kualifikimi, "Certifikata për SNKSP-të", për t'i pajisur kontabilistët e sektorit publik me një nivel ekuivalent të marrjes së njohurive dhe aftësive si edhe për Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në sektorin privat. Certifikata për SNKSP-të është e ngjashme me kualifikimet përkatëse të sektorit privat, sa i takon vëllimit mësimor, objektit të përmbajtjes, cilësisë së materialeve të përfshira në program dhe vlerësimit. Në mënyrë më të detajuar paraqitet në Shtojcën 1 të këtij raporti.

GJEORGJIA

21. Thesari i Shtetit pranë Ministrisë së Financave është përgjegjës për bashkërendimin dhe ndjekjen e përgjithshme të zbatimit të reformës së KSP-së. Të gjitha organizatat e përfshira në procesin arsimor janë përgjegjëse për të garantuar cilësinë dhe përmbajtjen e formimit, brenda lirisë dhe autonomisë së tyre akademike. Qendra Kombëtare për Zhvillimin e Cilësisë së Arsimit kryen vlerësime të programeve arsimore në institucionet e arsimit të lartë, për të vlerësuar cilësinë e tyre.

22. Nuk ka programe arsimore më vete për kontabilistët e sektorit publik në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve universitare. Një numër i kufizuar universitetesh në vend ofrojnë lëndë për KSP-në në kuadër të programit arsimor të përgjithshëm për kontabilistët. Megjithatë, universitetet të cilat ofrojnë tema të lidhura me sektorin publik në kuadër të programeve të tyre po i përditësojnë programet e lëndëve dhe librat shkollorë në përputhje me ndryshimet e bëra në politikat kontabël në kuadër të reformës.

23. Rritja e kapaciteteve të profesionit në kuadër të reformës së KSP-së po zbatohet me anë të zhvillimit të një kuadri arsimor të gjithanshëm për KSP-në nga qeveria, si pjesë e reformave të menaxhimit të financave publike, me përfshirjen e palëve përkatëse të interesit.

24. Mësimdhënia për KSP-në, në më të shumtën, është aktualisht përgjegjësi e Akademisë së Ministrisë së Financave. Formimi në përputhje me kuadrin e ri konceptual ka përfshirë një program të formimit të instruktorëve të formimit dhe një formim të mëposhëm në masë për personelin e financës dhe kontabilitetit në institucionet e pushtetit qendror, mbi temën e kontabilitetit dhe raportimit financiar mbështetur në SNKSP-të. Modulet e formimit mbulojnë financat publike dhe sistemet informatike; kontabilitetin financiar dhe raportimin financiar; raportimin financiar të avancuar (SNKSP); dhe procedurat dhe proceset e punës.

25. Qeveria dhe Akademia e Ministrisë së Financave po hartojnë bashkërisht politikën dhe programin për ZHVP-në për personelin e kontabilitetit dhe financës në pushtetin qendror dhe vendor, krahas një metodike vlerësimi dhe mjeteve për të mbajtur një program ZHVP-je të përditësuar.

26. Organizatat e profesionit kanë më së shumti anëtarë nga sektori privat. Për pasojë, ka mungesë të mbikëqyrjes së kontabilistëve të sektorit publik nga ana e OPK-ve dhe nuk ka një certifikim të veçantë profesional me objektiv KSP-në.

FILIPINET

27. Profesionit kontabël i Filipineve është njëri prej më të vjetërve në Azinë Juglindore. Profesionet kontabël rregullohen me Ligjin e Kontabilitetit të Filipineve, miratuar në vitin 2004. Në bazë të këtij ligji, ushtrimi i profesionit kontabël përfshin ndër të tjera: a) praktikën publike, b) praktikën në tregti dhe industri, c) praktikën në akademi/arsim dhe d) praktikën në qeveri. Titulli "kontabilist publik i certifikuar" mbrohet me ligj. Komisioni i Rregullimit Profesional është agjenci e pushtetit qendror, së cilës i është ngarkuar detyra të zbatojë me forcë ligjet me të cilat rregullohen profesionet e ndryshme. Në mandatin e saj përfshihet kryerja dhe administrimi i provimeve të licencimit për kandidatët dhe rregullimi dhe mbikëqyrja e praktikës së profesioneve, në partneritet me këshillat rregullatorë profesionalë. Këta këshilla rregullojnë ushtrimin dhe standardet etike të profesioneve përkatëse dhe akreditojnë organizatat profesionale.

28. Këshilli i Kontabilitetit është këshilli rregullator profesional për profesionin kontabël. Shtatë anëtarët e tij propozohen nga Instituti i Kontabilistëve Publikë të Miratuar i Filipineve, një OPK kryesore në vend, rekomandohen nga Komisioni i Rregullimit Profesional dhe emërohen nga Presidenti. Në bazë të Ligjit të rishikuar të kontabilitetit të vitit 1975, Këshilli i Kontabilitetit është përgjegjës për mbikëqyrjen, kontrollin dhe rregullimin e praktikave kontabël.

29. Themeluar në vitin 1929, Instituti i Kontabilistëve Publikë të Miratuar i Filipineve është njohur në vitin 1975 nga Komisioni i Rregullimit Profesional si organ zyrtar me përfaqësim të praktikës publike, industrisë, qeverisë dhe sektorëve arsimorë të Filipineve.

30. Për kontabilistët publikë të miratuar zbatohet një sistem certifikimi me dy nivele. Nuk ofrohet asnjë program i veçantë certifikimi për kontabilistët e sektorit publik; këta ndjekin kërkesat e përgjithshme për kualifikim dhe zhvillim profesional, të vendosura

për profesionin. Këshilli i Kontabilitetit përcakton dhe parashikon kriteret minimale për provimin e kontabilistëve publikë të miratuar; administron provimin; dhe u jep certifikatën kandidatëve të suksesshëm.⁸

31. Ka një kuadër të fortë të arsimit profesional, mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira. Niveli i ZHPF-së është i harmonizuar me Ligjin për arsimin e lartë (1994) dhe me kërkesat e miratuara nga Komisioni për Arsimin e Lartë, i cili punon me Këshillin e Kontabilitetit për vlerësimin e programeve të kontabilitetit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë. Këshilli i Kontabilitetit ka përfaqësues në komitetin teknik të Komisionit. Sa i takon monitorimit, Komisioni për Arsimin e Lartë bën vizita periodike në terren, të cilat i japin mundësi të identifikojë ecurinë e dobët dhe të ofrojë mbështetje për t'u dhënë zgjidhje problemeve të identikuara.

AFRIKA E JUGUT

32. Thesari i Shtetit⁹ është përgjegjës për bashkërendimin e arsimit për kontabilistët në sektorin publik, në nivel vendor, provincial dhe qendror. Ky institucion ka përgatitur një sërë fjalorësh të kompetencave teknike, të publikuara pas konsultimeve me shoqërinë profesionale dhe rrethet akademike, fjalorë të cilët përbëjnë kornizën e kompetencave. Në këta fjalorë përshkruhen aftësitë dhe njohuritë të cilat duhet t'i ketë një profesionist i aftë për të kryer një sërë detyrash standarde në nivele të ndryshme përgjegjësie brenda funksionit të përgjithshëm. Janë përgatitur gjithsej 10 fjalorë të kompetencave teknike, me qëllim për të ndihmuar në zhvillimin e burimeve njerëzore për menaxhimin e financave publike.

33. Thesari i Shtetit punon me dikastere të ndryshme, OPK-të dhe institucionet arsimore për të siguruar që kornizat e tyre të kompetencave të harmonizohen me fjalorët e kompetencave teknike.¹⁰ Nuk ka një program mësimor të përbashkët, por në vend të kësaj fjalorët përfshijnë udhëzime për zhvillimin e kualifikimit të kontabilistëve në sektorin publik. Prej individëve kërkohet të ndjekin rrugët studimore që përmbushin kriteret e nevojshme.

34. Certifikimi i kontabilistëve në sektorin publik mbështetet në përmbushjen e kualifikimeve të renditura në KKK.¹¹ Grumbullimi i vazhdueshëm i njohurive dhe aftësive të kontabilistëve të sektorit publik bëhet sipas niveleve të KKK-së, i miratuar nga Autoriteti Afrikanojugor i Kualifikimeve (SAQA).¹² SAQA rregullohet me Ligjin për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve¹³ dhe mbikëqyr zhvillimin e KKK-së përmes hartimit dhe publikimit të politikave dhe kriterëve për regjistrimin e organeve përgjegjëse për vendosjen e standardeve të arsim-formimit ose kualifikimeve dhe për akreditimin e organeve përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e rezultateve lidhur me këto standarde dhe kualifikime.

35. Akti nënligjor për regjistrimin e institucioneve private të arsimit të lartë (Udhëzimi APX-03) thotë se të gjitha institucionet private të arsimit të lartë duhet të dorëzojnë një listë të kontrolluar të të gjitha kualifikimeve që ofrojnë, përfshirë edhe kualifikimet e plota të cilat i përkasin arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe formimit të mëtejshëm, kualifikimet profesionale dhe kualifikimet e arsimit të lartë. SAQA lëshon konfirmim me shkrim se cilës nënkornizë kualifikimi i përkasin kualifikimet e cituara. Është në proces profesionalizimi i mëtejshëm i KSP-së. Rezultat i kësaj pritet të kërkohet si certifikimi kundrejt kualifikimeve sipas KKK-së, ashtu edhe anëtarësimi në një organ profesional.

⁸ <https://www.adb.org/sites/default/files/publication/27548/diagnostic-study-accounting-auditing-philippines.pdf>

⁹ <https://www.gov.za/about-government/contact-directory/departments/departments/national-treasury>

¹⁰ <https://oag.treasury.gov.za/Publications/Forms/AllItems.aspx?RootFolder=%2FPublications%2F18.%20Competency%20Framework%20for%20Public%20Financial%20Management%2FTechnical%20Competency%20Dictionaries%20-%20Explanatory%20Notes&FolderCTID=&View=%7BEA6E6B15-593D-4839-A804-A91A49CB20A0%7D>

¹¹ <https://www.saqa.org.za/national-qualifications-framework/>

¹² <https://allqs.saqa.org.za/>

¹³ Ligji për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, neni 67, viti 2008
<https://www.gov.za/documents/national-qualifications-framework-act>

VIETNAMI

36. Në nivel të ZHPF-së, universitetet ndjekin kërkesat e Ministrisë së Arsimit dhe Formimit.

37. Drejtorisë së Strategjisë për Kontabilitetin dhe Auditimin pranë Ministrisë së Financave i është ngarkuar detyra e nxjerrjes së akteve nënligjore për kontabilitetin dhe auditimin. Është duke u kryer vënia në zbatim e SVKSP-së, në bazë të SNKSP-ve. Po përgatiten materiale formimi për 11 SVSNK-të e publikuara për pjesëmarrësit në formim, kontabilistë publikë, studentë dhe drejtues.

38. Nuk ka një certifikim të posaçëm për kontabilistët dhe audituesit e brendshëm të sektorit publik dhe revizorët e shtetit. Të gjithë kontabilistët në Vietnam duhet të përmbushin kërkesat vjetore për ZHVP, për të ruajtur licencën dhe certifikatat e ushtrimit të profesionit. ZHVP-ja ofrohet nga organe të ndryshme, ndërsa MF-ja bën akreditimin e të gjithë ofruesve të ZHVP-së.¹⁴

ZAMBIA

39. Ministria e Financave bashkërendon arsimin kontabël në Zambia. Ajo vendos kriteret për kontabilistët, në bashkërendim me OPK-të kryesore. KSP bën pjesë në programin e përgjithshëm arsimor kontabël në universitet dhe në nivel OPK-je.

40. Zambia ndjek udhëzimet e FNK-së për arsimimin e kontabilistëve, në nivel ZHPF-je dhe ZHVP-je. Sipas ligjit të vitit 2021, ZICA ka tagrin të miratojë programet universitare lidhur me KSP-në. ZICA-s i është ngarkuar detyra të hartojë, nxisë dhe zbatojë në Zambia standarde të profesioneve kontabël të krahasueshme me nivelin ndërkombëtar. Ajo ndjek standardet ndërkombëtare të publikuara nën kujdesin e FNK-së dhe punon nga afër me Ministrinë e Financave për formimin e aftësive. Autoritetit të Arsimit të Lartë i është ngarkuar detyra të regjistrojë dhe rregullojë institucionet private të arsimit të lartë dhe të miratojë përmbajtjen e programit mësimor mbi kontabilitetin.

Autoriteti i Arsimit të Lartë dhe ZICA duhet të miratojnë bashkërisht programet e kontabilitetit.

41. Kualifikimi zambian për kontabilistët e sektorit publik është zhvilluar nga ZICA dhe ka marrë mbështetjen e Ministrisë së Financave, por nuk është certifikim i detyrueshëm për marrëdhëniet e punës.

ARSIMI PËR KSP-NË NË UNIVERSITETE

42. Në gjashtë vendet e analizuara përfshihen lëndë që kanë të bëjnë me KSP-në kurset e përgjithshme të kontabilitetit të ofruara nga universitetet në nivel të ZHPF-së, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve universitare. Megjithatë, KSP-ja mbulohet në formë të përgjithshme, për shembull organizimi dhe metodika e KSP-së me ndonjë hallkë lidhëse mes kontabilitetit dhe financës shtetërore. Temat nuk janë gjithmonë të ndërlidhura apo sistematike.

43. Pakica e formimit të specializuar për kontabilistët e sektorit publik, përfshirë mungesën e programeve më vete të kualifikimit për KSP-në në ciklin e parë apo të dytë të studimeve universitare, mund të sjellë boshllëqe në aftësitë dhe njohuritë elementare të kandidatëve për kontabilistë lidhur me KSP-në.

44. Universitetet e tre vendeve (Afrika e Jugut, Vietnami dhe Zambia) propozojnë një program më vete me diplomim në KSP.

SHQIPËRIA

45. Arsimi i lartë në Shqipëri ofrohet nga 13 universitete publike dhe 46 universitete private, prej të cilëve mbi 20 ofrojnë kurse të kontabilitetit dhe auditimit. Afro 80% e të gjithë studentëve pranohen në universitetet publike, prej të cilave më i madhi, më i vjetri dhe mbase më i respektuari është Universiteti i Tiranës, me 35 mijë studentë.¹⁵

¹⁴ <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/vietnam>

¹⁵ Aktiviteti 5, raport, zhvillimi i një kornize arsimore për zhvillimin e profesionistëve kontabël në sektorin publik, Zhvillimi i aftësive kontabël profesionale dhe një mekanizmi kontabël të qëndrueshëm në sektorin publik, grant SAFE Grant Nr. TF0A3277 (Pjesa A) grant SAFE Nr. TF0A5134 (Pjesa B) Shqipëri – Projekti i Zhvillimit të Kontabilitetit në Sektorin Publik

46. Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës ofron një sërë kursesh ku mbulohet KSP-ja. Sipas raportit të aktivitetit 5 të CIPFA-s mbi kuadrin arsimor për zhvillimin e profesionistëve të kontabilitetit në sektorin publik (nëntor 2022), programi i lëndës për kurset e kontabilitetit është i krahasueshëm me SNE-të por jo shumë me programin mësimor të CIPFA-s për sektorin publik për shkak të mbulimit të temave të KSP-së, sidomos të raportimit financiar të sektorit publik përfshirë SNKSP-të, dhe meqë ofrohen më së shumti vetëm në ciklin e dytë të studimeve universitare.

47. Disa universitete kryesore në Shqipëri ofrojnë program të KSP-së në ciklin e dytë (Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Korçës). Dy universitete të tjera (Universiteti i Durrësit, Universiteti i Gjirokastrës) kanë program të KSP-së në ciklin e parë të studimeve, jo në ciklin e dytë.

48. Në kuadër të procesit të reformës së KSP-së, planifikohet vënia në zbatim e një sistemi të integruar formimi për kontabilistët në sektorin publik, ku programi mësimor në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve universitare të harmonizohet me programin lëndor të CIPFA-s (shih Shtojcat 1 dhe 2).

GJEORGJIA

49. Një numër i kufizuar universitetesh ofrojnë elemente të lidhura me KSP-në në programin arsimor për kontabilistët në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Ky është shpesh një modul mbi KSP-në dhe raportimin.

50. Universitetet nuk kanë marrëveshje apo rregullime zyrtare me Ministrinë e Financave apo OPK-të lidhur me futjen e lëndëve që kanë të bëjnë me KSP-në në programin e tanishëm mësimor apo në praktikat mësimore të këtyre disiplinave.

51. Shumë pak jepet mësim për SNKSP-të dhe për kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara siç zbatohet në sektorin publik, në universitetet kryesore gjeorgjiane.

FILIPINET

52. Filipinet kanë mbi dy mijë institucione të arsimit të lartë, prej të cilave mbi 1500 janë në sektorin privat. Komisioni për Arsimin e Lartë është përgjegjës për planet, politikat, prioritetet dhe programet e arsimit të lartë: vendosjen e standardeve minimale për programet dhe institutet; monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve; dhe vendosjen e sanksioneve në rast të rezultateve të dobëta. Asnjëri prej universiteteve të shqyrtuara nuk ka konfirmuar se ofron program kontabiliteti të fokusuar në sektorin publik. Ofrohet një program i akredituar kontabiliteti në nivel BSc nga mbi 100 institucione publike dhe rreth 500 institucione private ku përfshihen disa elemente bazë të KSP-së. Numri mesatar i të diplomuarve është 12 mijë studentë në vit. Komisioni për Arsimin e Lartë vendos kërkesat për programin mësimor, duke ndjekur një qasje të mbështetur në rezultate dhe duke u përpjekur të zbatojë praktikën më të mira ndërkombëtare. Programi mësimor përfshin module të përgjithshme dhe module profesionale me 210 njësi krediti gjatë një periudhe katërvjeçare. Provimi i licencimit për kontabilistët e miratuar publikë mbështetet në kurset e kryera në programin e diplomës së kontabilitetit BSc.

53. Profesionalizimi i KSP-së bëhet në nivel të ZHVP-së, organizuar nga Shoqata Qeveritare e Kontabilistëve Publikë të Miratuar si OPK sektoriale për profesionistët e kontabilitetit që punojnë në agjencitë shtetërore të Filipineve. Është shoqata e parë sektoriale e kontabilistëve publikë të certifikuar në vend. Anëtarët e saj janë profesionistë të kontabilitetit që punojnë në agjenci të ndryshme shtetërore në mbarë vendin.¹⁶ Ka lidhje të forta midis universiteteve dhe programit të ZHVP-së të OPK-ve.¹⁷

¹⁶ <https://www.gacpa.com.ph/index.php/about-gacpa/gacpa-profile>

¹⁷ Republika e Filipineve – Raporti mbi Zbatimin e Standardeve dhe Kodeve në Kontabilitet dhe Auditim. Qershor 2017

AFRIKA E JUGUT

54. Në Afrikën e Jugut është zhvilluar një sistem arsimor për kontabilitetin me shumë nivele me grumbullim të kualifikimeve: nga niveli i ciklit të parë të studimeve universitare, deri në kualifikimin profesional, ku ZHVP-ja zgjat gjatë gjithë karrierës profesionale të kontabilistit.

55. Ka kualifikime dhe programe enkas për KSP-në në universitete dhe në institucione të tjera mësimore. Disa universitete kanë departamente/fakultete për udhëheqjen e sektorit publik.

56. Kuadri i kompetencave për kontabilistët e sektorit publik bën pjesë në fjalorët e kompetencave teknike, që mbulojnë grupet kryesore profesionale në fushën e menaxhimit të financave publike. Në to jepen njohuritë, aftësitë dhe përvoja e punës, të cilat duhet t'i ketë një profesionist i aftë për të kryer një sërë detyrash standarde në nivel të ndryshme përgjegjësie brenda funksionit të përgjithshëm.

57. Procesi arsimor për KSP-në për teknikët kontabël përfshin këto kualifikime:

- Certifikata e Teknikut Kontabël në Sektorin Publik (KKK – Niveli 3);
- Certifikata e Teknikut Kontabël në Sektorin Publik FET (KKK – Niveli 4);
- Certifikata e Kontabilitetit në Sektorin Publik (KKK – Niveli 5);
- Diplomë pasuniversitare për kontabilitetin e sektorit publik, ku përfshihet:
 - Menaxhimi i financave publike;
 - Raportimi financiar në sektorin publik (mjedisi i raportimit për njësitë e sektorit publik; kuadri i raportimit – parimet përgjithësisht të pranuar të praktikës kontabël; proceset e kontabilitetit në sektorin publik; hartimi i pasqyrave financiare; aktivet afatgjata; të ardhurat dhe kapital qarkullues; aktivet neto dhe detyrimet; standarde të tjera përgjithësisht të pranuar të praktikës kontabël; interpretimet dhe çështje të tjera të raportimit);
 - Strukturat dhe funksionet e sektorit publik;

- Auditimi dhe drejtimi i brendshëm në sektorin publik (sistemi i kontrollit të brendshëm dhe auditimi i jashtëm; mjedisi i auditimit të sektorit publik; llogaridhënia dhe drejtimi i brendshëm; identifikimi i rreziqeve dhe reagimi ndaj tyre në sektorin publik, përfshirë ekspertizën audituese; zbatime praktike)¹⁸ (shih shtojcat 4 dhe 5).

58. Arsimi i KSP-së në nivel ZHPF-je është i lidhur me ZHVP-në e ofruar nga OPK-të.

VIETNAMI

59. Universitetet vendosin kornizën e përgjithshme të programit mësimor për të gjitha programet e tyre në bazë të standardeve dhe udhëzimeve mbi programet formuese që vijnë nga Ministria e Arsimit dhe Formimit.

60. Përgjithësisht, ka një mbulim të kufizuar që i bëhet KSP-së në nivel të ZHPF-së, por disa universitete mbulojnë tema të lidhura me KSP-në në programet e tyre të ciklit të parë të studimeve, ku përfshihen:

- Kontabiliteti në sektorin publik (që mbulon një varg temash)
- Softuerët e kontabilitetit të sektorit publik
- Kontabiliteti i sektorit publik dhe mekanizmat financiarë
- Auditimi në sektorin publik – auditimi i brendshëm në sektorin publik
- Buxhetet dhe vlerësimi i performancës në sektorin publik
- Analiza e pasqyrave financiare të sektorit publik
- Kontabiliteti i drejtimit në sektorin publik
- SNKSP dhe SVKSP.

61. Disa universitete ofrojnë diploma të ndryshme kontabiliteti në ciklin e parë të studimeve, përfshirë kontabilitetin e shoqërive tregtare, auditimin dhe KSP-në. Diploma për KSP mbulon: 1) lëndë akademike (të lidhura me elemente të veçanta të menaxhimit të financave publike dhe të zbatimit të buxhetit) ku

përfshihen: regjimi i financave publike; kontabiliteti publik dhe analiza e pasqyrave financiare; auditimi publik; kontrolli dhe ekspertiza në sektorin publik; dhe standardet e sektorit publik; dhe 2) lëndë profesionale ku përfshihen: siguria e informacionit kontabël; drejtimi i burimeve njerëzore për organizatat publike; udhëheqja në sektorin publik; kontabiliteti i drejtimit në sektorin publik; kontabiliteti financiar tregtar; financat për shoqëritë tregtare; dhe sistemi i tatim-taksave.

62. Specializimi për KSP aktualisht ofrohet vetëm në nivel të ciklit të parë të studimeve në universitet, por plani është të ofrohet edhe në ciklin e dytë. Programi mësimor për KSP-në është hartuar në përputhje me bllokun arsimor të dijeve.

ZAMBIA

63. ZICA ka zhvilluar një diplomë në fushën e menaxhimit financiar në sektorin publik. Ka kritere pranimi, që varen nga niveli i certifikimit, përfshirë nivelin e kualifikimit paraprak dhe dëftesës së shkollës me notë 5+ në lëndët e matematikës dhe të gjuhës angleze.

64. Programet përfshijnë blloqet kryesore sa më poshtë:¹⁹

- MFP 1 Kontabiliteti në sektorin publik
- MFP 2 Aspekte juridike të financave dhe administratës së sektorit publik
- MFP 3 Drejtimi i brendshëm dhe administrimi në sektorin publik
- MFP 4 Menaxhimi i financave në sektorin publik
- MFP 5 Auditimet në sektorin publik
- MFP 6 Kuadri i Raportimit Financiar për njësitë e sektorit publik.

65. Nga viti 2021 deri në vitin 2023 ZICA aprovoi rreth tetë programe universitare mbi KSP-në.²⁰

66. Programi i Zambias për kontabilistët e autorizuar, i akredituar nga Autoriteti për Arsimin e Lartë, përfshin arsim për KSP-në nëpërmjet dy rrugëve të ndryshme në nivel të ciklit të dytë të studimeve:

67. Sektori publik:

- KA 3.7 Auditimi dhe sigurimi në sektorin publik
- KA 3.8 Menaxhimi i financave në sektorin publik

OPK-TË DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL NË KSP

68. OPK-të luajnë rol thelbësor në formimin kontabël për sektorin publik. Këtu përfshihet:

- **Vendosja e standardeve:** OPK-të mbështetin vendosjen dhe mbajtjen e udhëzimeve dhe standardeve kombëtare të kontabilitetit.
- **Zhvillimi i kurikulave:** OPK-të bashkëpunojnë me entet rregullatore dhe institucionet arsimore për përgatitjen dhe përditësimin e programeve mësimore të harmonizuara me standardet ndërkombëtare.
- **Akreditimi dhe certifikimi:** OPK-të përfshihen në akreditimin dhe certifikimin profesional dhe zakonisht ofrojnë formim për arritjen e niveleve përkatëse të kualifikimit.
- **ZHVP:** OPK-të janë ofrues kryesorë të programeve të formimit të ZHVP-së dhe të seminareve në mbështetje të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të kontabilistëve. Këto ofrojnë edhe mundësi për vendosje kontaktesh dhe ndarje njohurish mes profesionistëve të terrenit.
- **Puna bindëse dhe përfaqësimi:** OPK-të bëjnë punë bindëse për interesat e kontabilistëve dhe japin kontribut në diskutimet për politikën në lidhje me arsimin dhe praktikën kontabël. Ato përfaqësojnë profesionin në dialogun me organet shtetërore, autoritetet rregullatore dhe palë të tjera të interesit, për të siguruar që të marrin zgjidhje nevojat dhe shqetësimet e kontabilistëve të sektorit publik.

¹⁹ www.zica.co.zm/students

²⁰ <https://www.zica.co.zm/wp-content/uploads/2019/01/Accredited-Tuition-Providers-for-the-ZICA-Qualifications.pdf>

69. OPK-të luajnë rol të rëndësishëm në procesin e arsimit për KSP-në në të gjashtë vendet e vrojtuar, përfshirë dialogun me institucionet shtetërore, rregullatorët, universitetet dhe OPK të tjera brenda dhe jashtë vendit. Megjithatë, fokusi i tyre është më së shumti në sektorin privat. Për pasojë, mund të ketë mungesë të mbikëqyrjes së kontabilistëve të sektorit publik nga ana e OPK-ve, mungesë të një certifikimi të veçantë profesional dhe shumë pak kurse të ZHVP-së me objektiv KSP-në.

70. Prej vendeve të shqyrtuara, vetëm Filipinet kanë një OPK enkas për sektorin publik ku bashkohen profesionistët kontabël të cilët punojnë në institucione të ndryshme shtetërore në mbarë vendin.

71. Dy prej vendeve të vrojtuar (Filipinet dhe Zambia) kanë përcaktuar kriteret e kualifikimit të cilat duhet t'i përmbushin kontabilistët për të punuar në sektorin publik. Mirëpo, kualifikimi i kërkuar nuk është specifik për sektorin publik por është kualifikim në nivel të përgjithshëm profesional që ofrohet nga OPK vendase ose të huaja. Disa vende të vrojtuar (Afrika e Jugut, Shqipëria, Vietnami) po ecin drejt zhvillimit të një kriteri më zyrtar enkas për certifikimin e kontabilistëve të sektorit publik.

72. Kontabilistëve të sektorit publik, që janë anëtarë të OPK-ve, u kërkohet të kryejnë ZHVP në të gjitha vendet e vrojtuar (për shembull, për rinovimin e licencës në Filipine nevojitet marrja e 15 krediteve çdo tre vjet, në Afrikën e Jugut të gjithë ushtruesit e profesionit që duan të mbajnë certifikatë ushtrimi profesioni nga Shoqata duhet të bëjnë të paktën 40 orë ZHVP çdo vit, në Zambia kërkohen 40 orë ZHVP në vit), por këto kërkesa kanë të bëjnë më së shumti me të qenit anëtar si kontabilist i autorizuar i një OPK-je dhe nuk janë enkas për sektorin publik.

73. Institucionet formuese shtetërore ofrojnë ZHVP në dy vende të vrojtuar, në Gjeorgji dhe në Shqipëri. ZHVP ofrohet më së shumti nga OPK-të në vendet e tjera. Në disa raste, në ZHVP përfshihen universitetet dhe ofruesit e tjetër të formimit.

SHQIPËRIA

74. Të gjithë profesionistët kontabël në sektorin publik dhe në atë privat duhet të përmbushin kërkesat për ZHVP. ZHVP ofrohet nga OPK-të. Këto punojnë nga afër me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me universitetet për të zhvilluar njohuritë për SNKSP-të, programet mësimore, materialet, kapacitetin e instruktorëve dhe certifikimin (mbështetur në parashikimet për kontabilistët në sektorin privat).²¹ Shqipëria është në proces të zhvillimit të një sistemi unik të ZHVP-së për kontabilistët e sektorit publik, "korniza arsimore për zhvillimin profesional të kontabël të sektorit publik".²²

75. Instituti shqiptar i Kontabilistëve të Miratuar është një OPK kryesore në Shqipëri, e përfshirë në zbatimin e programit të reformës për KSP-në. Anëtarë të këtij instituti janë vetëm kontabilistë të miratuar. Në shtator 2020, Instituti ishte e vetmja OPK për kontabilistë e njohur nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Anëtarët e Institutit ofrojnë një larmi shërbimesh, si mbajtja e llogarive; përpilimi i pasqyrave financiare; hartimi i pasqyrave financiare të mundshme; këshillimi fiskal; këshillimi për drejtimin financiar; projektimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe shërbime të auditimit të brendshëm; auditimi jo ligjor; dhe shërbime të tjera në sektorin publik dhe atë privat. Instituti punon me CIPFA-n për të zhvilluar certifikimin për SNKSP-të (shih shtojcën 3 të këtij raporti).

GJEORGJIA

76. Aktualisht ka dy OPK, programet e certifikimit e të cilave njihen nga Shërbimi gjeorgjian për Mbikëqyrjen e Kontabilitetit, Raportimit dhe Auditimit:

- Federata e Kontabilistëve dhe Audituesve Profesionistë të Gjeorgjisë,²⁴ e njohur për të kryer ZHVP, provime dhe certifikim profesional të kontabilistëve dhe audituesve; dhe
- Federata e Audituesve, Kontabilistëve dhe Drejtuesve Financiarë të Gjeorgjisë,^{25,26} e njohur

²¹ https://cfrr.worldbank.org/sites/default/files/2020-10/ENG_ALBANIA_PATHWAYS.pdf

²² https://cfrr.worldbank.org/sites/default/files/2020-10/ENG_ALBANIA_PATHWAYS.pdf

²³ Zhvillimi i aftësive profesionale kontabël dhe i një mekanizmi të qëndrueshëm kontabiliteti në sektorin publik. Shqipëria – Stewart Macleod, nëntor 2022

²⁴ <http://gfpa.ge/site/index.php>

²⁵ <http://gfaafm.ge>

²⁶ <https://www.saras.gov.ge/Content/files/Georgia%20Benchmarking-report-eng.pdf>

për ZHVP dhe certifikim të audituesve, por jo për kryerjen e provimeve.

77. Nuk ka programe certifikimi të OPK-ve me fokus te KSP-ja.

78. Nuk ka një kërkesë të detyrueshme për ZHVP nga OPK-të në fushën e KSP-së. Akademia e Ministrisë së Financave mbetet burimi parësor i njohurive dhe informacioneve të përditësuara.

FILIPINET

79. Ka pesë OPK në bashkësinë profesionale kontabël të Filipineve, njëra është OPK sektoriale që merret enkas me çështje të KSP-së.

80. OPK-ja kryesore në vend është Instituti i Kontabilistëve Publikë të Certifikuar i Filipineve. Është një organizatë kombëtare profesionale e njohur dhe e akredituar për kontabilistët e miratuar publikë. Kryen katër funksione të rëndësishme: i) zbatimimi i kodit etik i miratuar nga Këshilli i Kontabilitetit, ii) kontrolli mbikëqyrës i zbatimit të programit të ZHVP-së, iii) publikimi i prononcimeve të Këshillit të Standardeve të Kontabilitetit dhe të Këshillit të Standardeve dhe Praktikave të Auditimit dhe publikimi i Buletinit tremujor të kontabilistëve dhe i periodikut tremujor "Kohët e Kontabilitetit," dhe iv) kryerja e punës bindëse në emër të profesionit kontabël. Të ardhurat i krijon nga kuotizacioni. Një tjetër burim të ardhurash është ofrimi i ZHVP-së dhe akreditimi i ofruesve dhe programeve të ZHVP-së.

81. Shoqata Qeveritare e Kontabilistëve Publikë të Miratuar është e para dhe e vetmja shoqatë e kontabilistëve publikë të miratuar në vend, nën ombrellën e Institutit të Kontabilistëve Publikë të Miratuar të Filipineve.²⁷ Është një organizatë e profesionistëve kontabël të cilët punojnë në institucione të ndryshme shtetërore në mbarë vendin. Ka rreth 10 mijë anëtarë dhe 25 degë në mbarë vendin.²⁸ Organizon dhe zhvillon një varg programesh

të zhvillimit profesional për kontabilistë në sektorin publik dhe ndjek përmbushjen nga anëtarët e saj të kërkesave për ZHVP. Kontabilistët e sektorit publik fitojnë njohuri të mjaftueshme në lidhje me KSP-në brenda programeve të ZHVP-së të ofruara nga kjo OPK sektoriale.

AFRIKA E JUGUT

82. Ka disa organe anëtarësimi dhe kontabilistët e sektorit publik zgjedhin të anëtarësohen në njërin prej tyre.

83. OPK-ja kryesore është Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Afrikës së Jugut, që është i përfshirë aktivisht në procesin arsimor të kontabilistëve të sektorit publik. Është organizatë anëtare e FNK-së dhe është e regjistruar pranë Autoritetit Afrikanojugor të Kualifikimeve si organ profesional. Instituti angazhohet për të ndihmuar anëtarët dhe qeverinë në funksion të përmirësimit dhe profesionalizimit të sektorit publik me anë të dialogut të rregullt me palët kryesore të interesit në sektorin publik (si Audituesi i Përgjithshëm, Shoqata e Qeverisjes Vendore, Thesari i Shtetit etj.), dhënies së mbështetjes teknike dhe punës mbrojtëse për përmirësime në legjislacion dhe standarde.

84. Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Afrikës së Jugut është organizatë jofitimprurëse me anëtarësim vullnetar, e cila ushtron veprimtari në përputhje me aktin e themelimit. Burimet parësore të të ardhurave janë kuotizacionet, tarifat nga seminare dhe aktivitete, si edhe fonde të donatorëve. Instituti është anëtar aktiv në një sërë forumesh ndërkombëtare si pjesë e punës mbrojtëse dhe merr pjesë në ndarjen e njohurive dhe vendosjen e standardeve në nivel global.

85. Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Afrikës së Jugut ofron disa kualifikime për teknikë kontabël, që njihen nga punëdhënësit dhe profesioni për cilësinë, rreptësinë dhe qasjen praktike (Shtojca

²⁷ <https://www.gacpa.com.ph/index.php/about-gacpa/gacpa-profile>

²⁸ Ka tri klasa anëtarësimi: 1) e rregullt (kontabilistë publikë të miratuar, të punësuar në çfarëdo dege, agjencie apo njësie të qeverisjes përfshirë shoqëri tregtare shtetërore ose nën kontrollin e shtetit), 2) e përjetshme (mund t'i jepet çdo anëtar i cili ka historik pozitiv për të paktën 5 vjet dhe ka kontribuar në përparimin e profesionit kontabël), 3) nderi (mund t'i jepet çdo personi, pavarësisht nga formimi apo profesioni, i cili ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e profesionit kontabël) (https://gacpa.com.ph/images/gacpa_by_laws.pdf).

4). Për kontabilistët e sektorit publik, ofrohen tre kualifikime—Sektori Publik: kualifikimi si teknik kontabël: niveli 3 KKK (120 kredite), niveli 4 KKK (120 kredite) dhe niveli 5 KKK (120 kredite). Këto mbulojnë tema që shkojnë nga të njohurit e procesit buxhetor deri te përgatitja e raporteve kontabël mbështetur në rezultatet e zbatimit të buxhetit (Shtojca 4). Ofrohet edhe një kualifikim në nivel doktorate (Shtojca 5).²⁹ Instituti ofron kompetencë dhe përputhshmëri cilësore për KSP-në me anë të ZHVP-së, kodit të sjelljes dhe kodit të etikës profesionale.

86. Profesionit kontabël në Afrikën e Jugut është përgjithësisht i vetërregulluar në nivelin profesional kontabël, me përjashtim të audituesve të regjistruar. Për të mbajtur certifikatën e ushtrimit të profesionit, të lëshuar nga Shoqata e Kontabilistëve Publikë të Miratuar, anëtarët duhet të kryejnë së paku 40 orë ZHVP për çdo cikël. Këto 40 orë duhet të përfshijnë 20 orë ZHVP (të strukturuar) të verifikueshme dhe 20 orë ZHVP (jo të strukturuar) jo të verifikueshme.

VIETNAMI

87. Ka dy OPK në Vietnam, Shoqata e Kontabilistëve dhe Audituesve e Vietnamit dhe Shoqata e Kontabilistëve Publikë të Miratuar e Vietnamit.

88. Shoqata e Kontabilistëve Publikë të Miratuar e Vietnamit është anëtare e FNK-së, merr pjesë në procesin e vendosjes së standardeve kombëtare dhe angazhohet në nxitjen e përdorimit të SNKSP-ve dhe veprimtaritë e lidhura me zbatimin e standardeve kombëtare të KSP-së, përfshirë pjesëmarrjen dhe kontributin në Projektin e përgjithshëm kombëtar për kontabilitetin dhe në Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të Thesarit dhe Buxhetit. Shoqata e Kontabilistëve Publikë të Miratuar e Vietnamit nuk promovon një kualifikim për KSP-në por, duke pasur parasysh numrin e anëtarëve që punojnë në sektorin publik, po zhvillon formim të ZHVP-së në përmbushje të nevojave të tyre për të kuptuar dhe zbatuar standardet dhe rregullat e reja të sektorit publik.

ZAMBIA

89. OPK-ja Instituti i Kontabilistëve të Miratuar i Zambias (ZICA) merret aktivisht me formimin e specialistëve të KSP-së. Ky institut ofron Diplomën për kontabilitetin e sektorit publik. ZICA është anëtare e FNK-së dhe anëtare themeluese e Federatës Mbarafrikane të Kontabilistëve.

90. Të gjithë kontabilistët profesionistë, përfshirë kontabilistët e sektorit publik, duhet së pari të jenë anëtarë të ZICA-s dhe të kenë një kualifikim të kontabilitetit profesional të njohur nga ZICA. Kualifikimi më i zakonshëm është "Programi i Kontabilistëve të Autorizuar të Zambias, që konsiston në tre nivele: CA Certifikatë në kontabilitet (niveli 4 i Kornizës së Kualifikimeve të Zambias (KKZ)) (teknik); CA Diplomë e aplikuar e avancuar në kontabilitet (Niveli 7 KKZ) (i licencuar); CA Profesionist këshilltar në kontabilitet (Niveli 9 KKZ) (i diplomuar). Secili nivel ka provimet dhe kriteret e veta të cilat duhen përmbushur përpara se të kalohet në nivelin tjetër.

91. Në vitin 2017 ka filluar Diploma në menaxhim financiar në sektorin publik. Ky program u drejtohet kontabilistëve që punojnë në sektorin publik ose atyre që po marrin formim si kontabilistë të cilët dëshirojnë të punojnë në menaxhimin financiar në sektorin publik.³⁰

92. Krahas kualifikimit të Kontabilistëve të Autorizuar të Zambias, kontabilistët e sektorit publik në Zambia mund të ndjekin edhe kualifikime të tjera profesionale, si ACCA, Instituti i Autorizuar i Kontabilistëve të Drejtimit ose kualifikimi i kontabilistëve publikë të miratuar.

93. Pasi merr një kualifikim profesional, kontabilisti i sektorit publik duhet të përmbushë kërkesat për ZHVP të vendosura nga OPK-ja ku bën pjesë, për të ruajtur të drejtën e ushtrimit të profesionit. Kjo përfshin pjesëmarrjen në kurse formimi dhe seminare për t'u përditësuar me ndryshimet në standardet dhe rregullat e kontabilitetit.

²⁹ <https://www.saica.org.za/become-a-member/how-to-become-a-member/accounting-technician-atsa/accounting-technician-atsa-qualifications>

³⁰ <https://www.zica.co.zm/wp-content/uploads/2023/03/PSFM.pdf>

3



GJETJET DHE PËRFUNDIMET KRYESORE

GJETJET KRYESORE

94. Analiza e qasjeve për arsimin për KSP-në në gjashtë vendet e përzgjedhura nuk tregon njëtrajtshmëri, por evidenton disa tema dhe çështje të përbashkëta, që përmbliidhen më poshtë:

- **Kalimi drejt SNKSP-ve** ka nxjerrë në pah nevojën për të përmirësuar aftësitë e kontabilistëve të sektorit publik në të gjitha vendet.
- Në shumicën e vendeve ende **mungon një qasje sistematike për ofrimin e formimit** për kontabilistët e sektorit publik. Kjo mund të çojë në boshllëqe të mundshme në aftësitë dhe njohuritë bazë të atyre që duan të jenë kontabilistë, në lidhje me KSP-në.
- Sistemi i formimit të specialistëve kontabël në të gjashtë vendet zakonisht përfshin **disa nivele**. Por kriteret për kontabilistët e sektorit publik ndryshojnë në secilin vend dhe nuk ka njëtrajtshmëri në kriteret e ZHPF-së, ZHVP-së apo certifikimit për kontabilistët e sektorit publik.
- Shumica e vendeve përdorin një **qasje të përzier për rregullimin e arsimit për KSP-në**, ku ministria e financave vendos kërkesat për kontabilitetin, ministria e arsimit vendos kërkesat për programet mësimore në nivel universitar, dhe me bashkëpunimin aktiv të bashkësisë profesionale dhe të OPK-ve kryesore.
- Vendet po e rritin vëmendjen ndaj programeve të **formimit enkas për KSP-në**, në nivel të ZHPF-së dhe të ZHVP-së, sidomos në ato raste kur programet e lëndës nuk përfshinin më parë studim të temave të KSP-së.
- Qeveritë dhe aktorë të tjerë në shumicën e vendeve po punojnë për ta rritur mbulimin e temave të lidhura me KSP-në në **nivel të ZHPF-së** në mënyrë që kontabilistët që duan të punojnë në sektorin publik të kenë njohuri dhe dije më të mira. Tashmë ofrohen në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve universitare module mbi KSP-në që kanë në qendër të vëmendjes kontabilistët me formim të përgjithshëm.
- Megjithëse vijon të mbizotërojë arsimi i përgjithshëm kontabël, disa **kualifikime po etiketohen si specializim për sektorin publik** (p.sh., kualifikime në nivel diplome, teknike apo profesionale). Diploma universitare enkas për KSP-në ofrohen në Afrikën e Jugut, Filipine dhe Zambia. Gjeorgjia, Shqipëria dhe Vietnami po mendojnë të zbatojnë një diplomë universitare më vete për kontabilistët e sektorit publik. Spikat një kualifikim në nivel teknik i etiketuar posaçërisht për sektorin publik dhe i ofruar nga OPK-ja në Afrikën e Jugut, si i vetmi kualifikim i etiketuar si KSP që ofrohet nga një OPK në të gjashtë vendet e shqyrtuara.
- Kontabilistëve të sektorit publik të cilët janë anëtarë të OPK-ve **u kërkohet të kryejnë ZHVP** në të gjitha vendet e vrojtuar, por këto kërkesa më së shumti kanë të bëjnë me statusin e tyre si anëtarë të OPK-ve, jo si kontabilistë të sektorit publik, dhe kështu nuk zbatohen për të gjithë kontabilistët e sektorit publik.

- **ZHVP ofrohet më së shumti nga OPK-të** në të gjitha vendet e shqyrtuara. Institucionet shtetërore të formimit ofrojnë ZHVP në Gjeorgji dhe Shqipëri, ndërsa në disa vende përfshihen universitetet dhe ofruet të tjerë të formimit.
- Qasjet për **kualifikimet për kontabilistët e sektorit publik ndryshojnë** në secilin vend. Për kontabilistët e sektorit publik duket se nuk ka filluar zbatimi i njëtrajtshëm i asnjë kërkesë të posaçme për kualifikim apo certifikim, megjithëse Afrika e Jugut, Filipinet dhe Zambia kanë përparuar brenda vendit në këtë aspekt.
- Nga të gjashtë vendet e vrojtuar, vetëm dy syresh (Filipinet dhe Zambia) kanë përcaktuar **kriteret e posaçme të kualifikimit** të cilat duhet t'i përmbushin kontabilistët për të punuar në sektorin publik. Mirëpo, kualifikimi i kërkuar nuk është specifik për sektorin publik por është kualifikim në nivel të përgjithshëm profesional që ofrohet nga OPK vendase ose të huaja. Disa prej vendeve (Afrika e Jugut, Shqipëria, Vietnam) po ecin drejt zhvillimit të një kriteri më zyrtar enkas për certifikimin e kontabilistëve të sektorit publik.
- **OPK-të luajnë rol jetik** në dhënien trajtë arsimit, formimit dhe zhvillimit profesional të kontabilistëve, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, duke qenë se japin kontribut në paprekshmërinë, efikasitetin dhe efektivitetin e menaxhimit financiar të sektorëve përkatës.
- Në të gjashtë vendet, bashkësia e profesionistëve përbëhet më së shumti nga kontabilistë të sektorit privat, prandaj edhe **OPK-të i kushtojnë vëmendje më së shumti sektorit privat**. Vetëm Filipinet kanë një OPK enkas për sektorin publik ku bashkohen profesionistët kontabël të cilët punojnë në institucione shtetërore. Rrjedhimisht, kontabilistëve të sektorit publik u mungon kontrolli mbikëqyrës nga OPK-ja, certifikimi i posaçëm profesional apo kurse të ZHVP-së enkas për nevojat e tyre.

PËRFUNDIME

95. Gjetjet mbështetin këto përfundime:

- Ofrimi efikas i arsimit të synuar për kontabilistët e sektorit publik pengohet nga mënyra e copëzuar e vënies në zbatim të tij. Shumë programe ekzistuese të ZHPF-së që ofrohen nga universitetet dhe OPK-të kanë shumë pak ose aspak mbulim të temave të sektorit publik dhe ka shumë pak kurse ZHPF enkas për sektorin publik (as nuk është e qartë nëse do të kishte interes të mjaftueshëm për një fokus të tillë në fazat fillestare të arsimit kontabël). Një hap i parë i mirë do të ishte përmirësimi i të gjitha kurseve ekzistuese të ciklit të parë të studimeve në universitet, për të përfshirë më shumë tema më të mira të lidhura me KSP-në, pasuar nga futja e më shumë kurseve me fokus në sektorin publik në ciklin e dytë të studimeve në universitet, për të filluar thellimin e specializimit.
- Vënia në zbatim e SNKSP-ve është faktori shtytës në të gjitha vendet e vrojtuar, për t'i kushtuar vëmendje përmirësimit të KSP-së. Nevoja për kuadro kontabël të afta dhe të formuara mirë në sektorin publik, për të zbatuar siç duhet kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara ka nxitur goxha përpjekje për t'u dhënë zgjidhje sfidave ekzistuese. Vendet po bëjnë të gjitha punë për të vënë në jetë ose për të përmirësuar një sistem koherent dhe të gjithanshëm arsimit, formimit dhe certifikimit të kontabilistëve të sektorit publik, përgjithësisht në bashkërendim me një kriter për ZHVP.
- Puna për reformat shpesh mbështetet nga organizata të huaja donatore dhe mund të ofrojë një model prej të cilit të mësojnë ose të cilin të ndjekin vendet e tjera që i kanë hyrë të njëjtit rrugëtim. Programi PULSAR i mbështet aktivisht vendet pjesëmarrëse në këtë fushë të rëndësishme të reformës për të përmirësuar kapacitetin dhe aftësitë e kontabilistëve të sektorit publik.

SHTOJCA

1

SHQIPËRIA: SISTEMI I INTEGRUAR I PLANIFIKUAR PËR FORMIMIN PËR KONTABILITETIN E SEKTORIT PUBLIK

Niveli	Përmbajtja e qasjes
Teknik	Programet për teknikët kontabël ofrohen shpesh si formim profesional drejtuar individëve që duan të zhvillojnë aftësi profesionale në fushën e kontabilitetit; Formimi profesional mund të ofrohet në arsimin e mesëm (klasa 10-12) ose pas arsimit të mesëm dhe mund të zhvillohet me anë të kurseve të veçanta, programeve të certifikimit/diplomimit, programeve të diplomave profesionale dhe ose stazhit profesionalit.
Cikli i parë i studimeve në universitet	Futja e kurseve themelore të KSP-së në programet mësimore të kontabilitetit që janë në përputhje me SNE-të, si: <ul style="list-style-type: none"> Bazat e SNKSP-ve Hyrje në menaxhimin e financave publike Bazat e analizës së buxhetit dhe administrimit Struktura dhe institucionet shtetërore
Cikli i dytë i studimeve në universitet	Zhvillimi i një programi ose disa programeve në këtë nivel studimesh, me fokus te temat e KSP-së OSE Përfshirja e kurseve të avancuara të KSP-së në programet mësimore të kontabilitetit që janë në përputhje me SNE-të.
OPK	Programe arsimore nga profesioni: Përfshirja e temave të KSP-së në programet arsimore të profesionit që janë në përputhje me SNE-të, të ofruara me anë të OPK-ve brenda vendit ose me anë të ofruesve të huaj, që mbështeten në kompetencat bazë themelore për të përgatitur për sektorin publik ata që duan të bëhen kontabilistë. Përfshirja e objektivave mësimorë shtesë për sektorin publik në këtë fazë do të lërë më pak për të mësuar nëpërmjet të mësuarit shtesë. Hyrja në profesion / certifikimi / kualifikimi: Përfshirja e temave të sektorit publik në certifikimet/kualifikimet e njohura nga FNK, të ofruara me anë të OPK-ve brenda vendit ose ofruesve të huaj, që mbështeten në kompetencat bazë themelore për të përgatitur për sektorin publik ata që duan të bëhen kontabilistë. Partneriteti me organizata mbështetëse për të vendosur një nivel anëtarësimi për sektorin publik. Anëtarësimi në një OPK anëtare në FNK do të kërkojë respektimin e Kodit Etik për Kontabilistët Profesionalistë të FNK.

Niveli	Përmbajtja e qasjes
Formimi shtetëror / akademia e financave	<p>Për të plotësuar kompetencat e fituara bazë, të ofrohet:</p> <p>Formim dhe arsim i gjithanshëm dhe i strukturuar, i përshtatur sipas kërkesave të veçanta të punës në nivele të ndryshme të kompetencave dhe përgjegjësisë. Për këtë qëllim mund të përdoret një ndërthurje e mësimit në klasë, në punë, në linjë dhe autodidakt. Partneriteti mund të shfrytëzohet për realizimin e këtij formimi dhe mund të mos jetë nevoja të ndiqen kurset për ato objektiva mësimore që janë arritur me anë të arsimit të mëparshëm.</p> <p>DHE</p> <p>Përvoja praktike në lidhje me zhvillimin e kompetencës profesionale. Përvoja praktike është pjesë integrale e Zhvillimit Profesional Fillestar (SNE 5).</p>

SHTOJCA

2

MODULET CIPFA PËR CERTIFIKIMIN PËR KONTABILITETIN NË SEKTORIN PUBLIK

Faza	Moduli
CIPFA, Certifikatë për kontabilitetin e drejtimit dhe kontabilitetin financiar	Kontabiliteti i drejtimit
	Kontabiliteti financiar
CIPFA, Diplomë për menaxhim financiar dhe auditim	Auditimi dhe siguria
	Planifikimi dhe menaxhimi financiar i biznesit
	Hartimi i strategjive dhe analiza e të dhënave
CIPFA, Diplomë për drejtim të brendshëm, administrim rreziku dhe tatim-taksa	Raportimi i biznesit
	Drejtimi i brendshëm dhe administrimi i rreziqeve
	Çështje fiskale dhe ligjore (Britania e Madhe dhe bota)
CIPFA, Diplomë për menaxhim të financave publike, raportim dhe ndryshim organizativ	Zbatimi i ndryshimeve në biznes
	Menaxhimi strategjik i financave publike
	Raportimi financiar në sektorin publik (Britania e Madhe dhe bota)
	Rast studimor strategjik
CIPFA, Diplomë për menaxhim të financave publike, raportim dhe auditim të përparuar	Auditimi i avancuar
	Menaxhimi strategjik i financave publike
	Raportimi financiar në sektorin publik (Britania e Madhe dhe bota)
	Rast studimor strategjik

SHTOJCA

3

INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR I SHQIPËRISË – PROJEKT- KURS PËR CERTIFIKIMIN PËR SNKSP-TË

Seanca ³¹	Përmbajtja
1	Hyrje në SNKSP Krahasim i SNKSP-ve dhe SNRF-ve Kudri konceptual Karakteristikat e sektorit publik dhe çfarë do të thotë kjo për raportimin financiar të OSP-ve
2	Pasqyrat financiare sipas kornizës së SNKSP-ve
3	SNKSP 1 Paraqitja e pasqyrave financiare SNKSP 2 Pasqyra e flukseve monetare SNKSP 3 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet SNKSP 24 Paraqitja e informacionit të buxhetit në pasqyrat financiare
4	Të ardhurat dhe burimi i fondeve për OSP-të SNKSP 9 Të ardhurat nga transaksionet me këmbim vlere SNKSP 23 Të ardhurat nga transaksionet pa këmbim vlere
5	Tema të sektorit publik (domethënë, që nuk gjenden në SNRF) SNKSP 22 Dhënia e informacioneve shpjeguese për informacionit financiar për sektorin e qeverisjes së përgjithshme SNKSP 24 Paraqitja e informacionit të buxhetit në pasqyrat financiare (përmbajtja e hollësishme dhe shembuj) SNKSP 32 Marrëveshjet koncesionare të shërbimit: koncesion-dhënësi SNKSP 42 Pagesat sociale
6	Aktivitet afatgjata SNKSP 17 Aktivitet afatgjata materiale

³¹ Seancat janë 3-orëshe, por kjo mund të ndryshojë për t'iu përshtatur organizimeve praktike të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar dhe nevojave të grupeve të veçanta.

Seanca ³¹	Përmbajtja
7	Aktivet afatgjata
8	SNKSP 5 Kostot e huamarrjes SNKSP 16 Aktivet afatgjata materiale të investuara SNKSP 21 Zhvlerësimi i aktiveve jo gjeneruese të flukseve monetare SNKSP 26 Zhvlerësimi i aktiveve gjeneruese të flukseve monetare SNKSP 31 Aktivet afatgjata jo-materiale
9	SNKSP-të të cilat janë të ngjashme në formë dhe në përmbajtje me SNRF-të përkatëse, por që
10	kërkojnë zbatim, shembuj ose kontekst nga sektori publik SNKSP 11 Kontratat e ndërtimit
11	SNKSP 12 Inventarët SNKSP 14 Ngjarjet pas datës së bilancit SNKSP 18 Raportimi i segmenteve SNKSP 19 Provizionet, detyrimet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara SNKSP 20 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura SNKSP 27 Bujqësia SNKSP 39 Përfitimet e punonjësve
12	Instrumentet financiare SNKSP 28 Instrumentet financiare: paraqitja SNKSP 29 Instrumentet financiare: njohja dhe matja SNKSP 30 Instrumentet financiare: dhënia e informacioneve shpjeguese SNKSP 41 Instrumentet financiare
13	Pasqyrat financiare të konsoliduara
14	SNKSP 34 Pasqyrat financiare të veçanta SNKSP 35 Pasqyrat financiare të konsoliduara SNKSP 36 Investimet në pjesëmarrje dhe në sipërmarrje të përbashkëta SNKSP 37 Marrëveshjet e përbashkëta SNKSP 38 Dhënia e informacioneve shpjeguese për interesat në njësitë e tjera SNKSP 40 Bashkimet në sektorin publik
15	Interpretimi i pasqyrave financiare Analiza e raporteve matematikore Vlerësimi dhe treguesit e ecurisë të sektorit publik Objektivat financiarë dhe jo financiarë (të brendshëm dhe të jashtëm)
16	Zhvillimet aktuale në programin e BSNKSP-së Kontratat e qirasë Trashëgimia Infrastruktura
17	Përsëritje
18	

SHTOJCA

4

KUALIFIKIMET PËR KONTABILITETIN E SEKTORIT PUBLIK NË AFRIKËN E JUGUT

<p>Teknik kontabël në sektorin publik, Niveli 3 i KKK-së (1 vit – 120 kredite)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Hyrje në kontabilitet • Shprehinë në punë • Puna me kompjuter • Etika profesionale • Buxheti dhe raportimi • Kryerja dhe kontabilizimi i pagesave • Kontabilizimi i të ardhurave dhe arkëtimeve
<p>Certifikata FET: Teknik kontabël në sektorin publik, Niveli 4 i KKK-së (1 vit – 120 kredite)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi dhe mbikëqyrja • Përdorimi i teknologjisë në kontabilitet • Etika profesionale • Përgatitja i rakordimeve dhe bilanceve vërtetuese • Pasqyrat Financiare • Rimarrja e debitorëve • Përgatitja dhe ndjekja e buxhetit
<p>Certifikata: Kontabël në sektorin publik, Niveli 5 i KKK-së (1 vit – 120 kredite)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi dhe drejtimi i ekipit • Formati i raportimit ekonomik dhe klasifikimi SCOA • Etika profesionale • Administrimi i buxhetit • Kontabilizimi i aktiveve dhe inventarit • Raportimi financiar • Sistemi i kontrollit të brendshëm, auditimi i brendshëm dhe auditimi i jashtëm

SHTOJCA

5

PROGRAMI I DOKTORATËS PËR KONTABILITETIN E SEKTORIT PUBLIK NË AFRIKËN E JUGUT



COLLEGE OF
ACCOUNTING
INSPIRING LEADERS. IGNITING OPPORTUNITY

DIPLOMË PASUNIVERSITARE PËR KONTABILITETIN NË SEKTORIN PUBLIK (CG034ACC11)

Ky program i kushton vëmendje fitimit të aftësive për kontabilitetin në sektorin publik, përfshirë aktet ligjore dhe rregullatore, rolin e qeverisë, kontabilizimin dhe raportimin e veprimeve financiare, sistemet e kontrollit dhe auditimet në njësitë ekonomike shtetërore, përgatitjen e buxheteve dhe parashikimeve dhe çështje të tjera të raportimit. Programi ofrohet prej vitit 2015, në përgjigje të nevojës së ngutshme në Afrikën e Jugut për drejtues financiarë të aftë dhe të përgjegjshëm në sektorin publik, në përmirësim të administrimit dhe raportimit në sektorin publik. Studentëve pasuniversitarë u ofrohet një rrugëtim drejt marrjes së kualifikimit përkatës pasuniversitar për të ecur përpara në karrierë në organizatat shtetërore në nivel qendror, në nivel province dhe në nivel të qeverisjes vendore,

si edhe në institucionin e kontrollit të lartë të shtetit të Afrikës së Jugut (AGSA).

Rritja e kërkesave: Diplomë *B Corn* (kontabilitet i përgjithshëm) ose diplomë universitare e ngjashme në kontabilitet (niveli 7 i KKK-së).

Kohëzgjatja: 1 vit me shkëputje nga puna ose 2 vjet pa shkëputje nga puna.

Mënyra e mësim: Programi konsiston në katër kurse, secili i përbërë nga një sërë modulesh. Nevojitet notë kaluese në të katër kurset, për të marrë diplomën pasuniversitare të kualifikimit për kontabilitet në sektorin publik. Prej vitit 2019, të katër kurset do të ofrohen edhe online, me anë të platformës UCT VULA. Studentëve u duhet të kenë kompjuter dhe internet.

Kërkesat dorëzohen online, zakonisht deri më 31 tetor, për regjistrimin në vitin e ardhshëm shkollor. Vizitoni: www.uct.ac.za

Për më shumë informacion, kontaktoni Ilse Lubbe në adresën ilse.lubbe@uct.ac.za ose administratoren e programit, Olivia Europa, në adresën olivia.europa@uct.ac.za

College of Accounting, Leslie Commerce Building,
level 4, Upper Campus, UCT
Telephone: 021 650 2269

Kurset e detyrueshme

Kodi i kursit	Emri i kursit	Kredite HEQF	Niveli HEQSF	Tarifat në 2018 ³²
ACC4036T	Menaxhimi i financave publike	36	8	14.710 R
ACC4037V	Raportimi financiar në sektorin publik	36	8	14.710 R
ACC4038V	Strukturat dhe funksionet e sektorit publik	24	8	11.990 R
ACC4039T	Auditimi dhe drejtimi i brendshëm i sektorit publik	24	8	11.990 R
Totali		120		53.400 R

Vlerësimi

Për secilin prej katër kurseve më vete: Vlerësime formuese (përfshirë dorëzimin e rregullt të detyrave dhe sprovave), së paku një provim në semestër dhe provimet përfundimtare.

Studentëve u kërkohet të arrijnë së paku 40% të pikëve maksimale për secilin kurs për të fituar të drejtën të bëjnë provimin përfundimtar në atë kurs. Rezultatet e detyrave të dorëzuara dhe provimeve semestrale gjatë vitit përbëjnë notën e vitit për secilin kurs. Nota e vitit përbën 40% të notës përfundimtare dhe provimi përfundimtar (përfshirë një detyrë, pjesë e tij) përbën 60% të notës përfundimtare.

Për të marrë kualifikimin si diplomë pasuniversitare në KSP, studentët duhet të marrin së paku notën 50% në secilin prej kurseve të veçanta. Studenti i cili ngel në njërin prej katër kurseve të diplomës, mund të marrë leje nga senati për të bërë një provim tjetër shtesë në atë kurs.

Rregullat për ripranimin

Studenti i cili nuk i përmbush kriteret e programit, pa kaluar dy vite shkollore, lejohet të reregjistrohet vitin e tretë për secilin prej kurseve ku ka ngelur në vitin e mëparshëm shkollor.

Asnjërit student nuk i lejohet të rihyjë në program në qoftë se ka ngelur dy herë në një kurs të programit.

Strategjia didaktike dhe mësimore

Programi përdor një ndërthurje të strategjive didaktike dhe mësimore të cilat nxisin punën autodidakte dhe dëshirën për të mësuar gjatë gjithë jetës te studentët. Kjo përputhet me misionin e universitetit për të qenë një prej universiteteve që dalin në pah me edukimin për gjithë jetën dhe që u jep zgjidhje problemeve me të cilat përballet shoqëria jonë. Studentët do të kenë në dispozicion të gjithë personelin që merr pjesë në program, për mbështetje akademike, në formën e konsultave dhe të këshillave individuale.

³² Nuk ka të dhëna për tarifën në vitin 2019

Modulet (përmbajtja mësimore e kurseve) dhe rezultatet për secilin kurs

Moduli	Menaxhimi i financave publike (ACC4036W) Studentët do të dëshmojnë aftësinë <ul style="list-style-type: none"> • për të hartuar, paraqitur, ndjekur dhe vlerësuar parashikime, buxhete dhe projekte • për të vlerësuar dhe raportuar rezultatet e menaxhimit financiar kundrejt objektivave të paracaktuar në bazë të politikave për menaxhimin financiar • për të zbatuar teknikat e kontabilitetit të drejtimit dhe menaxhimit financiar në arritje të objektivave strategjike të organizatës
1	Kontabiliteti i drejtimit strategjik
2	Sistemet e kontrollit në buxhet dhe administrim
3	Buxhetet kapitale dhe vlerësimi i projekteve
4	Financat publike dhe menaxhimi financiar
5	Menaxhimi i zinxhirit të furnitorëve
6	Menaxhimi i performancës
7	Menaxhimi i aktiveve
8	Menaxhimi fiskal

Moduli	Strukturat dhe funksionet në sektorin publik (ACC4038H) Studentët do të dëshmojnë aftësi <ul style="list-style-type: none"> • për të interpretuar, futur në zbatim, ndjekur dhe zbatuar legjislacionin përkatës brenda organizatës së sektorit publik (p.sh. PFMA, MFMA, rregulloret e thesarit të shtetit etj.) • për të zbatuar politikat e administratës publike brenda organizatës së sektorit publik
1	Roli, struktura dhe administrimi i qeverive
2	Qeveria e Afrikës së Jugut, struktura dhe administrimi i saj
3	Kuadri i menaxhimit të financave publike në Afrikën e Jugut
4	Të ardhurat dhe shpenzimet e shtetit
5	Njësitë ekonomike publike, njësitë ekonomike bashkiake dhe organet e shtetit
6	Çështjet aktuale

Moduli	Auditimi dhe drejtimi mi brendshëm i sektorit publik (ACC4039H) Studentët do të dëshmojnë aftësi <ul style="list-style-type: none"> për të projektuar, analizuar dhe vlerësuar sisteme informative financiare dhe të tjera të lidhura me të për ndjekjen dhe kontrollin e punëve për të identifikuar rreziqet dhe për të planifikuar punën në përmbushje të objektivave të një detyre auditimi të brendshëm ose të jashtëm
1	Sistemi i kontrollit të brendshëm dhe auditimi i jashtëm
2	Mjedisi i auditimit të sektorit publik
3	Llogaridhënia dhe drejtimi i brendshëm
4	Identifikimi i rreziqeve dhe reagimi ndaj tyre në sektorin publik, përfshirë ekspertizën audituese
5	Aplikime praktike

Moduli	Raportimi financiar në sektorin publik (ACC4037W) Studentët do të dëshmojnë aftësinë <ul style="list-style-type: none"> për të përgatitur, paraqitur dhe ndjekur informacionet e raportuara në përputhje me kornizat e raportimit financiar dhe standardet e zbatueshme për dhënien e informacioneve shpjeguese, për institucionet shtetërore për të interpretuar dhe analizuar informacionet dhe pasqyrat financiare për format organizative të pushtetit qendror, provincial dhe vendor (p.sh., bashki, njësi ekonomike shtetërore etj.)
1	Mjedisi i raportimit për njësitë ekonomike të sektorit publik
2	Kuadri i Raportimit – parimet PPNjK
3	Proceset e kontabilitetit në sektorin publik
4	Hartimi i pasqyrave financiare
5	Aktivitet afatgjatë
6	Të ardhurat dhe kapitali qarkullues
7	Aktivitet neto dhe detyrimet
8	Standarde të tjera PPNjK
9	Interpretimet dhe çështje të tjera të raportimit

PROGRAMI PULSAR

MENAXHOHET NGA:



BASHKËFINANCOHET NGA:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO